

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com




Viti XXIV - Nr. 7565 E mërkurë 20 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

Vështirë që Gjermania të ketë kaluar një fillim jave të dëshpëruar dhe drithëruese si kjo e tanishmja. Nga Moskë, ku kampionët e botës në futboll iu ...
Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE

"Divorc" me simotrën bavareze apo fundi politik i Merkel?


Opinion **i** Ditës

Prej 17 prillit, Shqipëria dhe Maqedonia po shpresojnë fort se Bashkimi Europian do t'u hapë negociatat e anëtarësimit, nisur edhe nga rekomandimi pozitiv ...
Vijon në faqen 21

Nga MIMOZA KOÇIU

Negociata për shqiptarët... me kushte



Maks Velo: Ja 4 problemet e projektit **"Teatri"**, sherr në komision, Veliaj: Do ndërtohet. Artistët: Ku është timonieri?
Përplasje mes deputetëve, opozita sulmon kreun e bashkisë, ndërhyr Garda. Aktorët: Mos luani me ne
FATMIRA NIKOLLI

Ka vijuar edhe më e ashpër dhe protesta e artistëve para Teatrit Kombëtar në kundërshtim të projektligjit që i hap rrugë shembjes së godinës dhe ndërtimit të një të riu me PPP. "Meqë kjo qeveri ka ardhur me platformë ..."
Në faqen 2-3

"KAMPI I BE"/ SIRIANET NE BALLKAN, ZDF-JA GJERMANE: SHQIPERIA NUK ESHTË KUNDER QEVERIA: KEMI KAPACITET PER 600 MIJE EMIGRANTE

Zv.ministri i Brendshëm, Julian Hodaj: Kemi "përballuar" luftën e Kosovës. Gazetarja gjermane: Pritja e emigrantëve në Shqipëri, ide e austriakëve



(Në foto) Zëvendësministri i Brendshëm, Julian Hodaj. Refugjatë (foto Ilustruese) Në faqen 6

REPLIKAT E DY KRYETAREVE

Rama: PD e zbrazur mendërisht. Basha: Silleni si banditë, mbrojtëm parlamentin
Në faqen 4-5

HETIMET

Banda e grabitësve të kasafortave, GPS-ja e makinave zbuloi të rinjtë
Në faqen 8

"MBROJTJE PER GRATE"

Shifra e frikshme, 1780 raste dhune në familje për vetëm 4 muaj
Në faqen 12

"VIP PAGES"

Relaks në det, ja VIP-at që nisën pushimet e para për këtë vit
Suplement

ASNJE I SHOQUAR



Vrasja e pronarit të servisit, dyshimi: Autori, vrasës me pagesë
Në faqen 10

Sulmohet me eksploziv 47-vjeçari. Dyshimi, ngjarja për shkak të detyrës si inspektor Tronditet Shkodra, tritol makinës së policit

Agim Bushgjoka, kolegëve: Nuk kam probleme dhe konflikte me askënd

Nga SENAD NIKSHIQI
SHKODËR - Një shpërthim sme tritol ka tronditur banorët e qytetit të Shkodrës. Mësohet se persona ende të paidentifikuar kanë vendosur eksploziv në makinën e një efektivit të policisë, Agim Bushgjoka. 47-vjeçari ndod



hej në shtëpinë e tij kur ka ndodhur shpërthimi në automjetin në pronësi të tij, që ishte i parkuar poshtë pallatit ku banon. si pasojë e shpërthimit të lëndës plasëse janë shkakuar vetëm dëme materiale. Burime zyrtare nga Drejtoria ...
Në faqen 11

TEATRI KOMBETAR PROTESTAT

Aktorët vijojnë protestën për truallin e godinën e Teatrit Kombëtar. Kjo nuk është tokë pa zot

Neritan Liçaj: Jam bir ushtaraku e në luftë me Ramën, mos luaj me fatin tim

Aktori: Timonieri ka ikur në drejtim të paditur

Fatmira Nikolli

Ka vijuar edhe më e ashpër dje protesta e artistëve para Teatrit Kombëtar në kundërshtim të projektligjit që i hap rrugë shembjes së godinës dhe ndërtimit të një të riu me PPP. "Meqë kjo qeveri ka ardhur me platformë rilindjeje, të tërheqë këtë projektligj dhe pastaj të bëjmë një ligj të mirë. Kryeministri po kërkoi asgjësimin e artistëve. Por kur vjen puna të asgjësimi, asgjësimin tim e vendos vetëm unë. Kur bëhet fjalë për mua, jemi në luftë. Jam në betejë dhe këtë e di mirë se jam djalë ushtaraku. Nuk mund të luaj me fatin tim. Do e vras, ose do më vrasë. Nëse tregon dashuri ka mirënjohje, ndryshon puna", - tha dje Neritan Liçaj. Ai tha se nëse pranon të jenë kryeshërbëtori ynë, duhet të ulet e të na shohë në sy. "E kuptoj dashurinë për pushtet dhe e kuptoj kur pushteti të errëson sytë e shikimin. Timonieri ka ikur në drejtim të paditur, jo në drejtimin e duhur. I shtrijmë dorën e le të vijë të bisedojmë. Nëse do rrimë secili nga ne në istikame, s'do zgjidhim asgjë. Ju shtrijmë dorën të gjithëve, edhe ministres", - tha Liçaj. Ai nga ana tjetër i bëri apel komunitetit ndërkombëtar të ndërhyjë për çështjen e teatrit. "Romana Vlahutin duhet të flasë. Europa vë bast se mbështet artistët. Nuk është lufta vetëm për një Teatër Kombëtar, por edhe një Teatër Kombëtar", theksoi Liçaj. Më tej, ai kërkoi të dijë çfarë do bëjnë deputetët e votuar nga populli. "Çfarë pozicioni do i japin vetes deputetët? Ata policë që do të vijnë të shembin teatrin, atë natë në darkë kur të shkojnë në shtëpi, ai i INUK çfarë do u thonë fëmijëve? Kur të jenë në darkë në shtëpi, a do jenë polici apo qytetari?", tha Liçaj. Sipas tij, kjo është Shqipëria - nuk është prova e



Neritan Liçaj, dje gjatë protestës së artistëve

VISJAN UKCENAJ

"Nuk është prona jote. S'ke për ta bërë vëlla. Aktorët e rinj duhet të vijnë këtu. Ata që s'kanë dalë kurrë në skenë, sepse kjo është skena më e rëndësishme e jetës së tyre. Duhet të vijnë artistët me lekë e pa lekë. Është t'i tregosh këtë shteti se nuk je pronar i asgjë".



askujt. "Kemi të drejtë të ekzistojmë e nuk duhet të jemi numra. Europa nuk funksionon kështu, këtë e dimë të gjithë. Nëse duan të jenë europiane, të fillojnë të mendojnë si europiane", tha ai. Më tej fjalën e mori Anila Bisha, e cila kujtoi se ka 27 vjet që punon në teatër që "kur Rama ia vuri syrin këtij teatrit, në fakt këtij trualli. Atëherë emrat e

ANILA BISHA

"Rama ia vuri syrin këtij teatrit, në fakt këtij trualli qëkur. Emrat e artistëve ishin të mëdhenj e askush nuk kishte frikën e kontratave. Ata arkitektët ishin drejtorë shteti. Aktorët janë në pikë të hallit. Aktorët janë nën terror. Ata që e kanë krijuar karrierën me talent. Shkojmë në VC-në e drejtorit kur dalim nga shfaqja se s'kanë investuar në këtë teatër", tha Bisha.



artistëve ishin të mëdhenj e askush nuk kishte frikën e kontratave. Ata arkitektët ishin drejtorë shteti. Aktorët janë në pikë të hallit. Aktorët janë nën terror. Ata që e kanë krijuar karrierën me talent. Shkojmë në VC-në e drejtorit kur dalim nga shfaqja se s'kanë investuar në këtë teatër", tha Bisha. Më herët aktivistja Alida Karakushi tha se në Komisionin e Medias u ndjenë si dekor. "Nuk u menaxhua mirë as nga PD. Kryebashkiaku nuk njih rregulloret. Stadiumi ishte pjesë e trashëgimisë kulturore, u shndërrua. Teatri ka komunitet, ka aktorë që kanë treguar integritet, si Kabashi, Ndrenika. Këtu ka komunitet e ka reagim. Ju që ofendonit protestuesit, jeni diktatorë. Kryebashkiak jeni mafioz, sharlatan, premtovë se s'do kishte leje. Sa leje ke dhënë? Presidenti të mos bëjë qoka me artistët, ndërsa opozita të ngrejë komision hetimor", tha aktivistja.

Maks Velo, vlerat dhe defektet e projektit

Maks Velo në "Studio e Hapur" me Eni Vasilin në "News24", ai tha se godina e Teatrit nuk duhet shembur dhe se evidentohej katër probleme. Sipas tij, problemi i parë është i tokës, problemi i dytë është i teatrit, problemi i tretë është trashëgimia dhe i katërti projekti. "Shpesh, mendohej t'i ngatërrojnë këto të katërta, ndonëse ato janë probleme veç e veç. Për mua, ajo tokë i duhej dhuruar Teatrit, për faktin se për kaq vjet, aty është zhvilluar një aktivitet i madh, janë krijuar institucione. Gjërat është si t'i gjykosh. Çdo gjë mund ta shembësh e shembim kryeministrinë e bëjmë një 10-katësh. Shembim komitetin qendror e shembim, bile u bë një projekt atëherë. Kështu nuk është kjo logjika, ajo ka vlera në ansamblin italian duke filluar nga matëritë, banka, teatri, Dajti, Kryeministria, akademia, universiteti. E shembem stadiumin. Rama thotë është shumë e mirë, por ajo është një gjë kaq gjigande, kaq e madhe, kaq e frikshme saqë po merr pjesë që tani mbi bulevardin i ka ardhur kaq afër kolonave. Nuk ka më shtat", tha Velo.

sonin e Medias u ndjenë si dekor. "Nuk u menaxhua mirë as nga PD. Kryebashkiaku nuk njih rregulloret. Stadiumi ishte pjesë e trashëgimisë kulturore, u shndërrua. Teatri ka komunitet, ka aktorë që kanë treguar integritet, si Kabashi, Ndrenika. Këtu ka komunitet e ka reagim. Ju që ofendonit protestuesit, jeni diktatorë. Kryebashkiak jeni mafioz, sharlatan, premtovë se s'do kishte leje. Sa leje ke dhënë? Presidenti të mos bëjë qoka me artistët, ndërsa opozita të ngrejë komision hetimor", tha aktivistja.




Kryebashkiaku Erion Veliaj, dje në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Robert Budina: Politika na përdori në Komisionin e Medias

I pranishëm paradi në Komisionin e Medias, në darkë, Robert Budina erdhi i zhgënjyer. Sipas tij, mbrojtja e teatrit nuk është fytyra jonë, sepse teatri është pronë publike jo vetëm e aktorëve. "Nuk u bë asnjë dëgjës sot në Kuvend, palët politike u përleshën. Na përdorën politikisht, siç bëjnë me çdo kauzë", tha ai. Në vijim, ai mohoi të ketë interesa politike e përfshirje politike. "Më akuzuan se kam axhendë, por nuk jam pjesë e asnjë partie. Kisha një interes që t'i jepnim dinjitet vetes. Politika fut hundët gjithandej. Kam qenë në grevën e urisë në fund të regjimit para ardhjes së demokracisë. Ne ikëm të bëjmë artin e politikën e bëjnë ata. Praninë tonë atje e shitën politikisht", tha Budina. Sipas tij, "nuk bëhet fjalë për të bërë teatër të ri, por kërkohet të luajmë me ne që të bëjmë çfarë të duan". "Nëse rezistojmë, do fitojmë. Kam një propozim: ftoj ata që iu dhem demokracia në Shqipëri të vijnë në këtë kauzë, ta fitojmë e secili të shpërndahet me pas. Ejani të japim një shembull", tha ai. Një ish-kryetar i këshillit bashkiak që kish ardhur si qytetar. "Pse nuk e okupojnë teatrin artistët? Të mos mblidhemi kot këtu. Institutet e Ndërtimit e shembën me fjalë. Si inxhinier them se ky ka kaluar 3 tërmete e rrezik shembjeje. Meritojnë teatër më të mirë, por ky të mos shembet", tha ai. Më tej, një tjetër qytetar që kish marrë pjesë në demonstratat e '90-ës tha se ka tërhequr zvarrë bustin e Enver Hoxhës e do tërheqë zvarrë këta. "Ndje zëra që më thonë na mbro. Ky është tempull e është i shenjtë. Të gjithë duhet të na bashkohen. Atyre monstrave u them: baballarë e nënat mos i doni, por atdheun duajeni".

Ervin Goce i shoqërisë civile tha dje se Veliaj është një individ i autorizuar, ka vajtur e ka prishur një dëgjësë, që është pjesë e detyrueshme. "Një individ që vrau 3 institucione. Ministria mori bllokun e mbajtiti ditat ku jimesh. S'e kuptoj se si aktorët i lanë gorillat politike të bëjnë grusht. Duhet që aktorët të thonë se Erion Veliaj s'mund të jetë negociator. Ka rënë Ministria e Kulturës, bashkia, gjykatat", shtoi ai.





Ndërhyn Garda e Republikës, kryebashkiaku braktis komisionin bashkë me Mirela Kumbaron

Shembja e Teatrit, sherre e dhunë te "Media", opozita sulmon Veliajn

Akuzat e PD: Mbylle çështjen "Gjoklaj". Veliaj: Tirana do fitojë

Fatmira Nikolli

Teatër në parlament, por pa nivel artistik. Sherr, fyerje dhe pothuajse dhunë. Është ky bilanci i mbledhjes së djeshme të Komisionit të Medias që qe paralajmëruar të jetë një dëgjese me ministrën e Kulturës Mirela Kumbaro për çështjen e Teatrit Kombëtar. Në komisionin e djeshëm, krahas saj për të raportuar për çështjen u paraqit edhe kryebashkiaku Erion Veliaj, çka u refuzua nga demokratët duke e kthyer takimin në një shfaqje të shëmtuar ku të gjithë flasin njëherësh pa aritur t'i qasen debatit për çështjen e ndërtimit me PPP të godinës së TK-së. Me pretendimin se Veliaj ishte i pafuqar, pavarësisht ndërhyrjes së deputetëve të majtë, që thanë se ftesa për raportim ishte prej tyre. Fillimisht, në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, debati nisi mes kryetares së Komisionit Albana Vokshi dhe kryetarit të Bashkisë, Erion Veliaj. Deri atë çast në sallë ishin edhe përfaqësues të Aleancës për mbrojtjen e Teatrit, Robert Budina dhe Taulanta Jup. Kur dëgjesa u kthye në sherr politik, ata braktisën komisionin. Së pari, Vokshi u drejtua kreut të Bashkisë së Tiranës, duke i kërkuar të mbyllte mikrofonin dhe të dilte jashtë se ishte i pafuqar ndërsa më pas i tha se do ta nxirrte jashtë. "S'ke shans të më nxjerrësh jashtë. Erdha për respekt në komision, tani ti më thua ik. Shfrytëzoni çdo kauzë për ta politizuar", tha në përgjigje Veliaj. Pas 30 minutash debat, media u nxor jashtë, për t'u rifutur pak minuta më vonë, kohë kur mbledhja pothuaj degjeneroi në dhunë. Ka qenë deputeti demokrat Flamur Noka, ai që është ngritur nga vendi dhe ka tentuar të nxjerrë kryebashkiakun jashtë komisionit, pasi ky i fundit refuzoi disa herë të zbatojë urdhrin e kryetares së këtij komisioni. Noka iu drejtua Erion Veliaj për ta ngritur nga karrigia ku ishte ulur dhe vetëm ndërhyrja e Gardës së Republikës shmangu përplasjen fizike. Më pas të gjithë të pranishmit u ngritën në këmbë duke diskutuar me tone të larta. "Garda të nxjerrë jashtë kryetarin e bashkisë, ndryshe do të kërkoj që të merren masa. Garda, zbatoni ligjin! Ju kam kërkuar që të nxirrni jashtë kryetar-



Komisioni i djeshëm për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

DEPUTETËT E PS

Gjatë përplasjes së deputetëve të PD-së me kreun e Bashkisë së Tiranës, 3 deputetët e majtë, Ilir Beqaj, Adelina Rista dhe Anduel Xhindi, janë bërë bllok bashkë me punonjësit e Gardës duke mos i lejuar kundërshtarët e tyre ta prekin kryebashkiakun e Tiranës.

PËRPLASJA

Në një moment kur Garda nuk po vepronte, atëherë deputeti demokrat Flamur Noka u ngrit nga karrigia e tij dhe iu afrua Veliaj për ta larguar nga komisioni. Por u ndesh në rezistencën e Gardës. Prapa Veliaj ishte Garda dhe nisi dhe një përplasje mes deputetëve PD dhe PS. (meshkuj). Garda nuk lejoi deputetët e PD-së t'i afrohen Veliaj. Ndërkohë Vokshi i kërkoj Gardës të nxjerrë jashtë Erion Veliajn.

ALBANA VOKSHI

"Dënoj me forcë largimin e ministres Kumbaro, e cila ishte thirrur për të dhënë llogari për Teatrin Kombëtar. Ky është fundi i parlamentarizmit. Mazhoranca nuk do që të bëjë transparencë për krimin që po bëhet me Teatrin Kombëtar", - deklaroi Vokshi.



Debati me Veliajn dhe përplasia me Gardën, Saliانji: Ja çfarë ndodhi në komision

Deputeti i PD-së, Ervin Saliانji sqaron në një prononcim për "BalkanWeb" se pse u rreshtua mes demokratëve që kërkuan me ngulm nxjerrjen e kryebashkiakut Erion Veliaj nga Komisioni i Medias. Ai foli për debatin me kryebashkiakun pak para se Flamur Noka të çohet nga vendi e të tentonte ta nxirrte me forcë nga komisioni. "Nuk është prona jote, je në vendin e gabuar në këtë komision", - këto janë fjalët që Saliانji i ka thënë kryebashkiakut në momentin që i është afruar. Deputeti i PD shton se reagimi i tij është i ligjshëm dhe gjithçka ndodhi për shkak të asaj që e quan, mbullim të vjedhjes së 205 milionë eurove nga qeveria. "E vërteta e plotë është që Veliaj vjen pa asnjë ftesë, duke mos respektuar Kushtetutën dhe ligjet, dhe tenton t'i imponohet parlamentit dhe ligjit. Reagova në kundërpërgjigje të dhunës më të lartë dhe më të rrezikshme, dhunimit të parlamentarizmit nga një bashkiak i llastuar. Shërrri dhe shamata që po bën qeveria është për të mbuluar vjedhjen e 205 milionë eurove, ndërsa ne po përballemi për interesin publik dhe për ligjshmëri", u shpreh Saliانji. Sipas tij, në komision nuk ka qenë i ftuar përfaqësuesi i firmës kështu që Veliaj si përfaqësues i interesit të firmës nuk kishte punë në komision. "Përftuesi i 205 milion eurove s'mund të kërkojë mirëkuptim që edhe të vjedhë edhe të uzurpojë parlamentin duke e trajtuar si sallë personale dhe jo si institucion. Gjithsesi i ofrojmë negociatorit "të fortë" që në këmbim të shlyerjes së kostove të daljes nga priza të kabullit të fonisë së mikrofonave, të heqin dorë nga 205 milion eurot e kullave me teatër", tha Saliانji. "Veprimi ndaj Gardës ishte simbolik, ndërgjegjësues, kë po mbronte Garda aty? Ne jemi deputetë që po kërkonim rikthimin e ligjshmërisë. Garda duhet ta nxirrte jashtë ndërkohë në shkëlqje të ligjit dilte përballë deputetëve", -tha ai.

DEBATI NË KOMISIONIN E MEDIAS

VELIAJ: Po bën teatër.
VOKSHI: S'e merni dot fjalën pa ua dhënë unë, ju bëni zhurmuesin atje.
VELIAJ: Sapo të thashë që nesër sheshi "Skënderbej" është për një çmim në Barcelonë, nuk vij dot.
VOKSHI: A mund ta mbyllni?
VELIAJ: Erdha siç më kërkuat.
VOKSHI: Mbyllni mikrofonin!
VELIAJ: Po gënjen!
VOKSHI: Mos u tregoi arrogant!
VELIAJ: Siç po bëni me aktorët dhe teatrin.
VOKSHI: Mos u bëni arrogant, mund të qëndroni më lart se kaq!
VELIAJ: Ki dinjitetin të thuash të vërtetën nëse do të bësh aktoren shko bëj audicion.
VOKSHI: Ki kujdes me gjuhën që përdor se juve...
VELIAJ: Erdha për respekt, edhe ti thua ik, keni frikë?
VOKSHI: Ti duhet të zbatosh ligjin.
VELIAJ: E humbisni kauzën, shkoni me bisht në shalë dhe Tirana fiton.
VOKSHI: Jeni bërë për të ardhur keq. Unë mund t'ju nxjerr dhe jashtë ke ardhur i pafuqar se nuk doni të keni ministrën vetëm.
VELIAJ: Iku koha kur ju nxirrni jashtë. Nesër merr çmim Sheshi Skënderbej nuk mund të jem. Ti do qetësohesh dhe do kuptosh se çdo sulm që keni bërë...
VOKSHI: Këtu drejtoj unë jo juve, mbyll mikrofonin. Veliaj: Shiko deputetët e PD të gjithë i ke për kafë te Pazari i Ri. Ke pasion të bësh aktore, dëshotove dhe ke sjellë teatrin në Parlament
VOKSHI: Të dalin kamerat përjashta. Pesë minuta pushim. Ndërprit mbledhja
VELIAJ: Pse ke frikë nga e vërteta? Të ka marrë në qafë kryeministri ty, që të thotë Pamela.
VOKSHI: I thashë Gardës po Garda ka frikë ta nxjerr jashtë, çfarë ti them unë Gardës. (Kërkon të ndërpresë mbledhjen sa të largohet Veliaj)
 Detaje

in e bashkisë, pasi është i pafuqar në komision. Ka ardhur që të prishë mbledhjen. Kërkoj ndërhyrjen e Gramoz Ruciçit", -tha Vokshi. "Të ka marrë në qafë kryeministri ty, që të thotë Pamela"-i tha Veliaj Vokshit. I mbrojtur nga Garda, Veliaj vijoi të debatonte me tone të larta me Vokshin në sallë. Si Noka, edhe Saliانji kërkoj të largonte me dhunë nga salla Veliajn, por hasi në rezistencën e Gardës.

Pas disa minutash debate, kryebashkiaku vendosi të largohet duke thënë "Tirana do fitojë". Pas tij u largua edhe ministria e Kulturës, Mirela Kumbaro, së bashku me deputetë socialistë. "Dënoj me forcë largimin e ministres Kumbaro, e cila ishte thirrur për të dhënë llogari për Teatrin Kombëtar. Ky është fundi i parlamentarizmit. Mazhoranca nuk do që të bëjë transparencë për krimin që po bëhet me Teatrin Kombëtar", - deklaroi Vokshi. Por, pas daljes nga salla, përplasia vijoi jashtë saj. Veliaj kërkoj të kishte një komunikim me median dhe ndërsa sqaronte pozicionin e tij, pas shpinës së tij, në kamera u shfaq, deputeti i PD-së Flamur Noka bashkë me kolegun Klevis Balliu që kanë nisur të flasin sërish. Mes tyre u zhvillua një tjetër debat i shkurtër dhe më pas Veliaj ka rimarrë fjalën para gazetarëve duke akuzuar opozitën se thotë "mos bëj si bëj unë, por bëj si them unë". "Ti e mbylle çështjen e Ardit Gjoklaj, ti po i vjedh qytetarët e Tiranës", tha Noka. "E mirë vazhdo. Ta lëmë të vazhdojë", -u tha Veliaj gazetarëve.

PROTESTA REAGIMET

Kreu i PD: Afera e Teatrit, grabitje kriminale nga kryeministri dhe klientë të tij

Përplasja, Basha: Rama sillet si bandit, zullumet do ta zënë poshtë

"Ne mbrojtëm parlamentarizmin, dhunuesit jeni ju"

Valentina Madani

Kreu i opozitës Lulzim Basha akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se po grabit pasuritë publike të vendit dhe se është bërë njësh me kriminelët për të mbrojtur. Z.Basha e konsideroi aferë dhe grabitje kriminale nga Edi Rama çështjen e Teatrit Kombëtar. Sipas tij, në këtë aferë do të vidhen pronat publike për kulla të larta të financuara nga paratë e kimit dhe drogës. Kreu i PD-së, iu kundërpërgjigj kryeministrin Rama, për atë çfarë ndodhi në Komisionin parlamentar të Medias, sipas të cilit "opozita mbrojti interesin publik dhe parlamentarizmin. Parlamenti duhet të përfaqësojë interesat e popullit dhe jo të mafias së ndërtimit, kimit dhe drogës". "Sot (dje) opozita mbrojti interesin publik dhe parlamentarizmin. Parlamenti duhet të përfaqësojë interesat e popullit dhe jo të mafias së ndërtimit, kimit dhe drogës. Por Edi Rama e ka të vështirë të bëjë dallimin midis batakut mes të cilit kalon gjithë kohën dhe parlamentit, prandaj edhe komentet e tij publike janë të gjitha me gjuhën e batakçiu", deklaroi z.Basha. Sipas Bashës, ajo çfarë po ndodh me Teatrin Kombëtar, është një grabitje kriminale që Edi Rama ka më se një vit që e përgatiti në bashkëpunim me klientët e tij. Në këtë aferë akuzon Basha do të vidhet prona publike për të ndërtuar kulla të larta që do financohen me para të kimit dhe drogës. "Ky që garantoj karrierën me 20 për qindshin për çdo leje ndërtimi dhe u ngrit në majë të politikës me formulën "një pallat, një votë", tani sillet si një bandit që do të grabisë 100 për qind të Shqipërisë. I dëshmtuar në qeverisje, i demaskuar para gjithë botës si i paafte, i korruptuar dhe i kalbëzuar moralisht, Edi Rama kërkoi ngushëllim dhe mbrojtje duke u bërë njësh me oligarkë, kriminelë dhe hajdutë për të mbrojtur pushtetin dhe bërë para duke betoni-



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

LULZIM BASHA

"Dhunuesi i Shqipërisë është Edi Rama që po na mbyll derën e Europës për të pestin vit me radhë. Sot ai mund të ngrejë kulla dhe të pastrojë paratë e drogës në çdo cep të Tiranës, por e afërt është dita kur këto zullume do ta zënë poshtë bashkë me Fikun e Tiranës!", - tha z.Basha.

Përplasja te Komisioni kuvendor i Medias

Hajdari "kundër" PD: Komisioni u kthye në boks politik, i shërbeu Veliajt

Kolegët demokratë u përfshinë në debate të forta me kreun e bashkisë, në mbrojtje të çështjes së Teatrit Kombëtar për deputeten e PD-së, Rudina Hajdari e gjithë ajo që ndodhi të "Media" i shërbeu Erion Veliajt. Deputetja më e re e parlamentit, vajza e liderit të dhjetorit Azem Hajdari e ka parë si shfaqje përplasjen e kolegëve të saj demokratë me kryebashkiakun Veliaj duke u distancuar nga qëndrimi i grupit parlamentar. Sipas saj, mbledhja nuk pati asnjë rezultat për kauzën e teatrit. Përmes një statusi në Twitter pak orë pas mbledhjes ajo shkruan se: "Shfaqja e sotme (dëshme) në Komisionin e Medias nuk i shërbeu aspak kauzës së teatrit, por u kthye në një boks politik dhe nuk dha asnjë rezultat. Përkundrazi, mos trajtimi i temës se Teatrit i



Deputetja e PD-së, Rudina Hajdari

REAGIMI

Deputetja më e re e parlamentit, vajza e liderit të dhjetorit, Azem Hajdari e ka parë si shfaqje përplasjen e kolegëve të saj demokratë me kryebashkiakun Veliaj duke u distancuar nga qëndrimi i grupit parlamentar.

shërbeu Erion Veliajt dhe interesit të tij të ngushtë, por jo të opozitës, artistëve dhe qytetarëve". Mbledhja e djeshme e Komisionit të Medias u shoqërua me tension, pasi deputetët e opozitës u ngritën kundër pranisë së

Erion Veliajt atje. Në këtë mbledhje ishte parashikuar të zhvillohej një seancë dëgjimore për Teatrin Kombëtar, por situata degradoi nga përplasje verbale deri në përplasje fizike.

zuar dhe grabitur Shqipërinë", u shpreh kreu i PD-së. Duke reaguar mbi statusin e Ramës për dhunë fizike në parlament nga ana e deputetëve të PD-së, Lulzim Basha akuzoi kryeministrin si dhunues të parlamentit,

Kushtetutës dhe ligjit. "Dhunuesi i shqiptarëve është Edi Rama që pasi u vodhi votën, po vjedh edhe pasurinë publike për të shtuar pasurinë e vet private. Dhunuesi i Shqipërisë është Edi Rama që po na mbyll derën e Europës

për të pestin vit me radhë. Sot ai mund të ngrejë kulla dhe të pastrojë paratë e drogës në çdo cep të Tiranës, por e afërt është dita kur këto zullume do ta zënë poshtë bashkë me Fikun e Tiranës!", u shpreh kreu i opozitës Lulzim Basha.



AFERA E TEATRIT

Parlamenti duhet të përfaqësojë interesat e popullit dhe jo të mafias së ndërtimit, kimit dhe drogës. Sot (dje) opozita mbrojti interesin publik dhe parlamentarizmin. Parlamenti duhet të përfaqësojë interesat e popullit dhe jo të mafias së ndërtimit, kimit dhe drogës.



Berisha për Veliajn: E nxorën jashtë si qen me bisht ndër shalë

Ish-kryeministri Sali Berisha komentoi dje situatën e paprecedentë të krijuar në Kuvendin e Shqipërisë, ku kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj tentoi të uzurpojë në mënyrë të paligjshme Komisionin e Medias. "E nxorën si qen me bisht ndër shalë", shkruan ish-kryeministri Sali Berisha në Facebook, duke komentuar vendosmërinë e kryetares së komisionit, Albana Vokshi dhe deputetëve të opozitës. Sipas ish-kryeministrin Berisha, "një horr, bandit i veshur me pushtet duke menduar se pushteti i pakufishëm i tij e lejon të ulet i pafutur, të marrë mikrofonin dhe të blloktoj mbledhjen e komisionit në kundërshtim flagrant me rregulloren e parlamentit!". "Një akt prej banditi i Lal Plehun, të parlamentit që mori përgjigjen e merituar! Të dashur miq, për herë të parë në historinë 27-vjeçare të parlamentit, pushton seancën e punimeve të komisionit parlamentar Erion Veliaj, një horr, bandit i veshur me pushtet duke menduar se pushteti i pakufishëm i tij e lejon të ulet i pafutur, të marrë mikrofonin dhe të blloktoj mbledhjen e komisionit në kundërshtim flagrant me rregulloren e parlamentit! Deputetja Albana Vokshi, kryetare e komisionit dhe deputetët e tjerë të opozitës mbrojtën me vendosmëri parlamentarizmin dhe nxorën jashtë si qen me bisht nën shalë, Lal Plehun, dhe, së bashku me të, ndrikull Kumbaron, që ndan me të vëllain paratë e taksapaguesve shqiptarë! Një përhëndetje të përzemërt për zonjën Vokshi dhe deputetët e opozitës që përzënë Lal Plehun nga parlamenti!", shprehet z.Berisha.

AKUZA

Sipas ish-kryeministrin Berisha, "një horr, bandit i veshur me pushtet duke menduar se pushteti i pakufishëm i tij e lejon të ulet i pafutur, të marrë mikrofonin dhe të blloktoj mbledhjen e komisionit në kundërshtim flagrant me rregulloren e parlamentit!"



Kryeministri reagon pas përplasjeve të deputetëve të PD-së me Veliajn

Rama: PD, e zbratur mendërisht, e ktheu debatin parlamentar në dhunë

Balla: Po shqyrtojmë rregulloren për shkarkimin e Vokshit

Darina Tanushi

Një parti të zbratur mendërisht e politikisht ishtë, e cilësoi dje kryeministri Edi Rama, Partinë Demokratike, e cila sipas tij, "është angazhuar fizikisht dhe e ka kthyer debatin parlamentar në një teatër gjuhësh e gjymtyrësh të dhunshme". Pas zhvillimeve në Komisionin parlamentar të Medias, Rama reagoi në rrjetin social "Facebook": "Një parti e zbratur mendërisht e politikisht (se shpirtërisht ka friuar me kohë), por e angazhuar fizikisht e ka kthyer debatin parlamentar në një teatër gjuhësh e gjymtyrësh të dhunshme! Pse të mos u japim një leje ndërtimi tek SHQUP-i për Kullën e Sporteve Trup me Trup?". Pak më herët, menjëherë pasi nga salla e mbledhjes së komisionit ishte larguar ministria Mirela Kumbaro, kreu i Bashkisë së Tiranës dhe deputetë e maxhorancës, kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla tha se ishin 2/3 e deputetëve të komisionit që kërkuan prezencën e Veliajt dhe Kumbaros në komision. Balla ka paraqitur dokumentin e procedurës së komisionit para gazetarëve. Sipas Ballës, është e papranueshme që një parti politike të dërgojë në komisionin deputetë të pajisur me vezë në xhapa për të sulmuar punonjësit e Gardës. "Sot konstatuam aktin e radhës së thyerjes së rregullores nga një person i propozuar nga PD-ja për të drejtuar Komisionin e Medias dhe Edukimit. Në mënyrë të përsëritur, Vokshi e ka kthyer këtë komision në një mjet personal. Dua të bëj publik dokumentin që 11 anëtarë të përherëshëm kanë kërkuar praninë e Veliajt dhe Kumbaros. E falënderoj Veliajn që pranoi të merrte pjesë në komision. Ka qenë kërkesë e 2/3 në komision. Aktorët e SHQUP-it, të pajisur me vezë. Klevis Balliu ishte armatosur me vezë në të gjithë xhepat e mundshëm të pantallonave. Salianji dhe Noka donin të dhunonin punonjësit e Gardës", u shpreh Balla para gazetarëve. "I bëj thirrje PD-së dhe kryetarit Lulzish Basha të frenojë deputetët e tij nga këto akte të



Kryeministri Edi Rama

PETRIT VASILI
Kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili është treguar mjaft i ashpër në reagimin e tij ndaj maxhorancës. "Parlamenti tashmë ka përballë gremenin mendore të kryeministrit në ditë të hallit. Funkionimi minimal i parlamentit nuk ekziston më. Banditizmi qeveritar ka rrëzuar përtokë çdo normalitet në Kuvend, ka shqyer rregulloren e Kuvendit dhe çmenduria ka zaptuar Kuvendin", tha dje Vasili.

DEPUTETI I PS-SË, STERKAJ NË GJENDJE TË RËNDË

Rreth orës 10:00 të mëngjesit të djeshëm, deputeti socialist Paulin Sterkaj ka pësuar ishemi cerebrale. Menjëherë është dërguar për në spital ku kanë shkuar me urgjencë edhe ministria e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu dhe kreu i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla. Kryeministri Edi Rama shprehu solidaritetin me deputetin: "Miku ynë Paulin Sterkaj po kalon një provë të vështirë pas një befasi së shëndetësore, të cilën Lutemi ta përballojë si kampioni që kemi njohur gjithnjë, qysh në rininë e hershme, kur ngrinte peshë zemrat e sportdashësve brenda e jashtë vendit. Forca miki! Jemi të gjithë me ty", shkroi dje Rama.

Kryeministri tregon historinë me turistin polak

Rama në Durrës: Jemi vend me siguri të lartë e çmime të lira

Kryeministri Edi Rama kishte i pranishëm dje në Durrës për promovimin e turizmit në këtë qytet. Ai tha se duhet të ndryshojmë imazhin e vendit tonë, në mënyrë që të shtohet ndjeshëm numri i turistëve. "Një turist politik erdhi dhe rrinte në aeroport, tha dua: roje me pushkë e makinë të blinduar. Nuk kemi ne i thamë, por të nesërmen erdhi dhe më kërkoi falje për të më thënë që e kishte imagjinuar Shqipërinë krejt ndryshe", tregoi Rama. "Ne po përgatitemi për një inovacion të rëndësishëm teknologjik në funksion të



biznesit të formalizuar; bazuar në një model të suksesshëm në Kroaci. Regjistrimi 'online' i çdo transakcioni në kohë reale. Kështu lehtësohen bizneset nga barra e rëndë e mbajtjes së kasave

etj. Ajo që keni gati është një masë lehtësuese për të gjitha bizneset. Për të gjitha këto biznese do të bëjmë një ulje 3-fish të takses, nga 15% - 5% të tatimit fitim. Kështu, bizneset e vogla mund të ndahen nga gënjeshtra me xhiron dhe të mos kenë stres, të mos u tremben inspektiveve tatimore e të mos bëjnë kukafshe-tasi me shtetin", u shpreh Rama. Sipas tij, "Shqipëria është nga vendet më të sigurta po të shohësh shifrat e po të degjosh dëshmitë e turistëve. Jemi vend me siguri të lartë, me çmime të lira dhe me mikpritje fantastike", - tha Rama.

me vendim gjykatë të formës së prerë Taulant Ballën. Sipas tij, "veza e madhe" në Komisionin e Medias ishte grupi parlamentar i PS-së dhe "zogu" brenda vezës ishte "zogu" vrasës i Tiranës, Lali Kulla.



Prefekti i Kukësit: Nuk firmos për Mazrekun

Gafur Mazreku nuk bëhet "Qytetar Nderi". Prefekti i Kukësit, Zenel Kuçana deklaroi dje se nuk e konfirmon vendimin e këshillit bashkiak për të shpallur qytetar nderi ish-deputetin socialist, i dënuar sepse plagosi deputetin Azem Hajdari brenda në Kuvend. "Vendosa të mos e konfirmoj vendimin, sepse biesh me ligjin për dekoratat dhe titujt e nderit të Republikës së Shqipërisë", u shpreh Kuçana në një prononcim për mediat. Kuçana i kërkon këshillit bashkiak të jetë i kujdesshëm në raste të tilla e të zbatojë aktet juridike dhe të zbatojë me korrektësi ligjin. Në 1997 Gafur Mazreku plagosi deputetin e PD, Azem Hajdari, por nga kjo e hënë për 13 anëtarët e Këshillit të Bashkisë Has, ish-deputeti socialist Gafur Mazreku duhej të ishte "Qytetar Nderi". Me 13 vota pro e një abstencim, ku këshilltari i PS nuk votoi pro dhe ku dy anëtarë të PD nuk morën pjesë në votim, Mazreku mori titullin me motivacionin "Personalitet intelektual, për kontribut të pashoq në pushtetin vendor".

Mesi: Së shpejti miratojmë "Kartën e Qytetarit"

Qe veria shqiptare pritet të miratojë së shpejti "Kartën e Qytetarit". Zvkryeministria Senida Mesi sqaroi dje në një takim informal punë me gazetarë të mediave të ndryshme se kjo është një kartë informuese, e cila do t'ju bëjë të qartë qytetarëve se si ata mund të kërkohet të drejtat e tyre në institucionet e shërbimit publik. Në çdo institucion ku merren shërbime publike, këto të drejta do të jenë në një kënd të caktuar, në mënyrë që çdo qytetar të dijë se ku të ankohet dhe çfarë të kërkohet. Në një shpjegim të përgjithshëm të mënyrës se si po funksionon Reforma në Administratën Publike, Shërbimin Civil dhe Shërbimet Publike, së bashku me shefin e Bashkëpunimit pranë Delegacionit të Bashkimit Evropian, Mario Marianin dhe drejtorin Ekzekutiv të ADISA-s, Lorin Ymeri, zvkryeministria kërkoi bashkëpunim me qytetarët, në mënyrë që ata të denoncojnë të gjitha pakënaqësitë me emra konkretë për të sjellë një shërbim më të mirë. Nga ana e tij, shefi i Bashkëpunimit pranë Delegacionit të Bashkimit Evropian, Mario Marianin shprehu domosdoshmërinë dhe nevojën që Shqipëria të ketë një administratë të fortë publike, për shkak se një vend që kërkon të anëtarësohet në BE ka të tjera sfida në këtë fushë.

DREJTËSIA REAGIMET

Zv.ministri i Brendshëm flet për kapacitetet mikpritëse të vendit tonë

Kampi i BE, qeveria: Mund të presim deri në 600 emigrantë

'ZDF'-ja gjermane: Shqipëria nuk është kundër

Ndërkohë që kryeministri Rama i cilësoi fantazi gjithë sa u thanë për mundësinë e ngritjes së një kampi refugjatësh në Shqipëri, media gjermane 'ZDF' në një reportazh të bërë dje shkruan se qeveria shqiptare nuk është kundër. "Më shumë refugjatë në Ballkanin Perëndimor", ky ka qenë titulli i reportazh gjerman dhe kanë zhvilluar një intervistë me zv.ministrin e Brendshëm, Julian Hodaj. "Në të ashtuquajturën rrugë Ballkanike Perëndimore nga Greqia nëpërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera në Austri, numri i refugjatëve po rritet përsëri", është kjo një pjesë nga reportazhi i "ZDF". Gazetarja gjatë përshkrim-it të situatës thotë: "Sipas qeverisë austriake, në Shqipëri mund të krijohet qendër refugjatësh për të gjithë BE. Edhe qeveria shqiptare duket se nuk është kundër. Ajo shpreson për mbështetje financiare dhe anëtarësim në BE". Në intervistën e tij, Hodaj deklaroi se Shqipëria ka kapacitete të mëdha për të mbajtur emigrantë, por nuk u shpreh qartë nëse do të ketë kamp. "Shqipëria ka kapacitete të mbajë deri në 600 mijë refugjatë. E ka treguar këtë edhe në të kaluarën gjatë luftës së Kosovës", ka thënë Julian Hodaj.

Ja çfarë ka thënë dhe kryeministri Bullgar disa javë më parë në Shqipëri. "Në Shqipëri do të bëhet një qendër koordinimi për luftëtarët që kthehen nga ISIS në territorin e Ballkanit", u shpreh Kryeministri i Bullgarisë, Boyko Borissov, në konferencën e përbashkët për shtyp me Ramën disa javë më parë.

DENONCIM I BERISHËS

Ish-kryeministri Berisha shkruan sot se ndryshe nga sa është deklaruar, Rama është gati të presë 600 mijë refugjatë sirianë, ish-terroristë të ISIS, në këmbim të hapjes së negociatave. Berisha poston në faqen e tij në 'FB' deklaratën e dhënë nga zv.ministri i Brendshëm,

Hodaj, për rrjetin televiziv më të madh gjerman, 'ZDF'.
POSTIMI I BERISHËS
Rama ofrohet të pranojë

600 mijë refugjatë sirianë, ish-terroristë të ISIS, në këmbim të hapjes së negociatave!

Të dashur miq, Edi Rama me zëdhënësin e tij, Hodaj, deklaroi sipas rrjetit televiziv më të madh gjerman 'ZDF', se Shqipëria ka kapacitete të plota për një kamp prej 600 mijë refugjatësh sirianë në Shqipëri. Rama përdor si argument pranimin nga Shqipëria të vëllezërve nga Kosova gjatë luftës për çlirimin e saj!
LEXONI MESAZHIN E QYTETARIT DIXHITAL SB.

"Dr. Sapo e dha 'ZDF'-ja për Aufnahmestellen, azilantët janë bo gati, fringo të reja dhe po funksionojnë. Zv.ministri Hodaj thotë që kanë kapacitet dhe eksperiencë për deri në 600.000 azilantë nga Siria etj."



Julian Hodaj
Zv.ministrin i Brendshëm, Albanien
Julian Hodaj

AKUZAT

"Trafiqet vazhdojnë, Tahiri është i lirë, hetimet për Habilajt dhe Xhafajt nuk dihet ku janë, ministrat e korruptuar flenë si qenga, Erioni ia jep Teatrin Kombëtar privatit që të bëjë pallat e ta shesin bashkë dhe Rama qeveris pa atë gjembin që quhet Gjykatë Kushtetuese. Tranzicion i përhershëm si gjithmonë", tha z.Blykybashi.

Bllokohet hetimi i Tahirit, PD-ja fajëson policinë. PS: Opozita nuk do hetim për drogën

Edhe pse në kushte jo normale pune, komisionet e përhershme parlamentare janë mbledhur, por që kur opozita përqendroi betejën e saj tek sulmi ndaj ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, u duk se harroi hetimin e saj parlamentar për kultivimin dhe trafikimin e drogës kur ishte Saimir Tahiri ministër i Brendshëm. Kjo hidhet poshtë nga Edi Paloka, kryetari demokrat i komisionit, i cili akuzon për bllokim policinë, Ministrinë e Brendshme dhe Kryeministrinë. "Drejtoria e Policisë kërkoi dy javë më tepër nga afati që ne i kishim përcaktuar. Kanë kaluar dy muaj tashmë. Ministria e Brendshme vendosi një afat absurd prej 3 muaj



jsh për të sjellë informacionet. Sot ka kaluar edhe ky afat absurd dhe nuk ka asnjë informacion. Ndërkohë që Shërbimi Informativ i ka sjellë informacionet", u shpreh Paloka për "TCH". Duke e quajtur justifikim, nënkryetaria socialiste e komisionit, Ermonela Felaj

tha se puna mund të vijojë me informacionet që kanë ardhur: "Përgjigje ka sjellë Qendra Kombëtare e Biznesit dhe Gjykata e Tiranës. Kjo e ndihmon komisionin për të vijuar punën". Felaj sheh si shkak për bllokim edhe faktin se demokratët nuk duan të hetojnë çështjen e drogës ndër vite, për çka socialistët kanë kërkuar vetë informacione në institucione. Paloka ka edhe një pohim që e quan të sinqertë: "Nga Tahiri kemi kaluar të Xhafaj, nga Xhafaj të ISIS-it, të deti që i jepet grekut, të nafta që i jepet rusit... Në çdo moment Rama nxjerr një skandal të ri dhe kjo e shpërndron vëmendjen e politikës. Por, nuk është kjo arsyeja që komisioni na ngelur në këtë fazë".



Tabaku: 250 mln euro korrupsion me tendera, Rama shkatërroi 'Kushtetuesen'

Deputetja e PD-së, Jorida Tabaku denoncoi dje korupsionin që sipas saj po bëhet nga qeveria. Gjatë ndërhyrjes në Komisionin e Ekonomisë, Tabaku vuri në dukje se korrupsioni është një nga pengesat kryesore për hapjen e negociatave. "Në periudhën 2014-2018, qeveria ka dhënë në shumë se 36 mijë tendera, ndër to, me negociocim pa shpallje janë dhënë pothuajse 10 mijë tendera. Një në tre tendera jepet pa garë. Pothuajse 250 milionë euro jepen pa konkurruar", - tha Tabaku. Ajo përmendi se nëse ligji do të zbatohet, do të kurseheshin të paktën 60 milionë euro, një fond i mjaftueshëm për të ndër-tuar jo 1 teatër, por 2. Jorida Tabaku ngriti si shqetësim kryesor mungesën e Gjykatës Kushtetuese, e cila siç theksoi nënkryetaria e Komisionit të Ekonomisë, është nxjerrë jashtë funksionit që opozita dhe qytetarët të mos kenë ku të godasin vendimet antikushtetuese. "Ligji i veçantë për Aeroportin e Vlorës nuk çohet dot në Gjykatë Kushtetuese. Ligji i veçantë për shembjen e Teatrit Kombëtar nuk çohet dot në Gjykatë Kushtetuese, VKM-ja abuzive për 'Air Albania' nuk çohet dot në Gjykatë Kushtetuese. Edi Rama po shndërrohet në një diktator", - u shpreh Jorida Tabaku, e cila vuri në dukje se edhe për Bashkimin Europian është e papranueshme nisja e negociatave me një vend ku nuk ekziston Gjykata Kushtetuese.

PD, Murrizi: Vëllezërit Xhafaj nuk janë si vëllezërit Zena

Deputeti i PD-së, Myslym Murrizi në Komisionin parlamentar të Sigurisë ku u diskutua për dhunën dhe krimin, akuzoi se Policia e Shtetit në këto 5 vite nuk ka pasur kohë të merret me këto probleme, pasi është marrë me trafikun e drogës. Referuar vëllezërve Xhafaj, deputeti tha se mazhorancës i është dukur sikur ata kanë folur për vëllezërit artistë Zena, por në të vërtetë PD ka folur për Fatmir dhe Agron Xhafaj. "Disa herë opozita ka bërë me dije edhe për ish-ministrin edhe për ministrin, që kemi kaluar një ligj për vetëingun e 14 mijë trupave, për mospasjen e kredibilitetit moral që ky ministër të jetë në krye të këtij ligji. Në formularin e tyre do të thuhet nëse gjatë karrierës së tyre a kanë takuar ndonjë njeri të inkrimnuar, të pandehur kur vetë ministri ka vëllanë e tij as të pandehur dhe as kontingjent, por të faktuar dhe të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata italiane si pjesë dhe trafikant droge", tha Murrizi. Sipas tij: "Shpesh u kemi thënë vëllezërit Xhafaj, por mesa shoh nga mazhoranca, nga ata që kanë tagrin e vendimmarrjes, iu është dukur sikur kemi thënë vëllezërit Zena. Jo, jo kemi thënë vëllezërit Xhafaj. Sepse njëri është në burg për trafik droge në Romë, tjetri do të bëjë reformë të 14 mijë trupat e policisë, nëse kanë takuar Agronin e këtij apo ju. Ju e keni marrë sikur kanë qenë vëllezërit artistë".



Presidenti i Republikës, Ilir Meta deklaroi dje se politika jonë e jashtme duhet të jetë larg ndikimit të interesave të politikës së ditës. Këto deklarata Presidenti Meta i bëri në një takim me Këshillin e Ambasadorëve Shqiptarë, të kryesuar nga presidenti i këtij Këshilli, ish-ministri i Punëve të Jashtme, Besnik Mustafaj. Qëllimi i këtij takimi ishte njohja me misionin dhe programin e kësaj organizate, të themeluar nga një grup ish-ambasadorësh të Republikës së Shqipërisë si dhe bashkëpunimi me Institucionin e Presidencës, në funksion të politikës së jashtme të Shqipërisë thuhet në njoftimin për

Presidenti i Republikës pret Këshillin e Ambasadorëve Shqiptarë

Meta: Politika e jashtme të jetë larg interesave të politikës së ditës



Presidenti i Republikës, Ilir Meta me Këshillin e Ambasadorëve

shtyp të Presidencës. "Krijimi i këtij Këshilli - tha Presidenti Meta - është një nisim dhe vyer, e cila do të ndi-

hmojë me kontributin, përvojën dhe këshillat profesionale në çështje të rëndësishme të politikës së jasht-

me. Prania gjithëpërfshirëse e shumë personaliteteve të diplomacisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare është garanci për afirmimin e Këshillit të Ambasadorëve si një forum i pavarur dhe i orientuar nga interesat kombëtare", vlerëson Presidenti, Z. Meta u shpreh gjithashtu se politika jonë e jashtme duhet të jetë larg ndikimit të interesave të politikës së ditës, e maturuar dhe e përgjenduar në interesat e qëndrueshme kombëtare, si dhe të ndërtohet mbi besueshmërinë afatgjatë ndaj aleatëve dhe partnerëve tanë.

Frenimi i flukseve migratore, Komisioni Evropian mbledh ministrat e Brendshëm të Ballkanit Perëndimor në Bruksel

Avramopoulos: Asnjë diskutim për kampe në Shqipëri

"Nëse kjo çështje del në pah pas disa kohësh, do ta diskutojmë"

Darina Tanushi

Çështja e emigrantëve vijon të jetë shqetësuese për Bashkimin Evropian e për këtë arsye, këtë të martë në Bruksel u mbajt një ministerial i ministrave të Brendshëm të vendeve të Ballkanit Perëndimor, thirrur nga Komisioneri për Emigracionin, Dimitris Avramopoulos. Por për herë të parë, ky i fundit ka komentuar edhe zërat për ngritjen e kampeve të refugjatëve në Shqipëri. "Asnjë iniciativë e tillë nuk është diskutuar në Bruksel, as me Shqipërinë dhe as me një vend tjetër. Ajo çfarë diskutuam është se si të adresojmë më mirë së bashku emigracionin e paligjshëm. Për ne, vendet e Ballkanit Perëndimor janë partneret më të rëndësishme për të adresuar dhe për të folur për këtë çështje. Por, asnjë çështje për ngritjen e kampeve në Shqipëri apo në ndonjë vend tjetër nuk u diskutua. Nëse kjo çështje del në pah pas disa kohësh, do ta diskutojmë, por për momentin nuk është një çështje për ne", u shpreh Komisioneri për Emigracionin. Gjatë takimit me ministrat e Brendshëm, Komisioneri Avramopoulos u shpreh se situata nuk është në krizë si 3 vite më parë, por sërisht Evropa është nën presion. Sipas tij,



Takimi i ministrave të Brendshëm, dje në Bruksel

OLTA XHAÇKA

Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka po zhvillon një vizitë zyrtare në Londër. Gjatë kësaj vizite, Xhaçka do të takohet me Sekretarin e Shtetit për Mbrojtjen, Williamson. Ministria Xhaçka gjithashtu do të zhvillojë takime edhe me ministra të qeverisë britanike si dhe në Dhomën e Lordëve.

GENT CAKAJ

Këshilli i Ministrave ka emëruar Gent Cakajn në postin zëvendësministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme. Gent Cakaj, filozofi i ri nga Kosova ka qenë këshilltar i kryeministrit Rama, ndërsa në postin e ri do të zëvendësojë Kleopatra Maliqin, e cila u shkarkua pak ditë më parë. Kleopatra Maliqi është emëruar drejtoreshë e Shkollës së Administratës Publike.

vendet të mbajë përgjegjësitë që i takon për përbashkëta, pasi çdo lëshim i një vendi do të kthehet në barrë për tjetrin. "Ne i njohim përgjegjësitë tona edhe në këtë rast, ashtu sikundër kemi vepruar dhe jemi angazhuar me shumë përgjegjësi në sfidat të mëdha, si ato për çështjet e azil kërkit, luftës ndaj terrorizmit dhe krimit të organizuar e në një sërë fushash të tjera me interes të përbashkët me vendet anëtare të BE-së", u shpreh z.Xhafaj. Në këtë kontekst, vendet e rajonit u angazhuan gjithashtu të vazhdojnë përpjekjet e përbashkëta në luftën kundër terrorizmit dhe në adresimin e fenomenit të luftëtarëve të huaj, duke parandaluar ekstremizmin dhe radikalizmin e dhunshëm, si dhe të rrisin përpjekjet në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit të armëve të zjarrit. Takimi dëshmoi edhe njëherë gatishmërinë e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së për të thelluar më tej bashkëpunimin dhe ndërveprimin mes tyre për të adresuar sfidat e përbashkëta. Takimi u zhvillua gjithashtu edhe në kontekstin e përgatitjes së ministerialit të ardhshëm, që do të zhvillohet në Tiranë më 4 dhe 5 tetor, me pjesëmarrjen e ministrave të Brendshëm mes BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Shpëtim Idrizi: Çështja çame nuk është më pjesë e qeverisë

Kryetari i PDIU-së, Shpëtim Idrizi Idrizi tha dje se çështja çame nuk përfshihet më në anëndën e qeverisë. Gjatë një interviste në "News 24", Idrizi u shpreh se çamët nuk kanë bashkëpunuar asnjëherë me fashistët dhe nazistët. "Çështja çame nuk duhet të ngarkohet me harresë, por të jetë pjesë e identitetit kombëtar. Kemi kulmuar dhe me një aktivitet jubilar. Synimi ynë është që kjo çështje të mos harrohet. Shqiptarët e Çamërisë nuk kanë bashkëpunuar me fashistët dhe nazistët", u shpreh kreu i PDIU-së. I pyetur në lidhje me lëvizjet e dy deputeteve të PDIU-së drejt PS-së, Idrizi tha se ky ishte një lajm i vjetër: "Për PDIU, ajo që na ndan dhe bashkon është çështja çame. Deputetja e dytë mesa di nuk është larguar, siç edhe ajo deklaroi. Këtë radhë kishim më shumë vota dhe ne gëllëm me 3 deputetë. Akti i fundit i luajtur ishte me deputetin Rakipi, i cili u akuzua për një gjë që s'u mor vesh. Ajo që është me rëndësi është fakti që me mungesën e deputeteve të PDIU në Kuvend, jo për shkak të votave, pasi në u rritëm me vota. Sot ku jemi? Çështja çame nuk është më pjesë e qeverisë", tha Idrizi.

SHQIPËRIA

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj ishte në këtë takim me ftesë të Komisionerit për Migracionin, Punët e Brendshme dhe Shtetësinë të Bashkimit Evropian, z.Dimitris Avramopoulos. Ministri Xhafaj theksoi në fjalën e tij se përgjigja e vendeve të rajonit duhet të jetë e njëzëshme, ku secili nga

të gjithë duhet të jenë vigjilentë që të mos lejohet një përqendrim i situatës në muajt e ardhshëm kritik të verës. "Muajt e fundit një rrugë e re është hapur, që tashmë prek Shqipërinë, Malin e Zi dhe Bosnjën dhe natyrisht që kjo ka ndikim në vendet e BE-së në veri. Edhe pse numri nuk është alarmues në këto momente,

ka interes të opinionit publik mbi këtë çështje dhe ne duhet të tregohemi të qetë, por bashkëpunues dhe mbi të gjitha të ndërmarrim aksione të koordinuara nga të gjithë ne. Ne duhet t'i kushtojmë më shumë rëndësi rritjes së lëvizjeve dytësore, që përfshijnë edhe rrugë kalimi të reja", u shpreh Avramopoulos.





Shqiptarët e arratisur

Të arrestuarit, nën akuzë për 72 vjedhje me mbi 400.000 euro

Prenë hekurat e dritares, arratisen 3 shqiptarë nga qelitë e paraburgimit në Greqi

GREQI - Tre shtetas shqiptare të arrestuar për vjedhje në Greqi, janë arratisur ditën e djeshme nga policia e lagjes "Argjirupi" Athinë pasi kanë sharruar hekurat e dritares dhe më pas janë hedhur nga një lartësi prej 10 metra. Arratisja ndodhi në orët e para të mëngjesit të së martës. Mësohet se të arrestuarit ishin pjesë e një bande me 5 anëtarë, të cilët u

GRUPI KRIMINAL

Arratisja ndodhi në orët e para të mëngjesit të së martës. Mësohet se të arrestuarit ishin pjesë e një bande me 5 anëtarë, të cilët u kapën me akuzën e 72 vjedhjeve në zonën e Atikës me mbi 400.000 euro.

kapën me akuzën e 72 vjedhjeve në zonën e Atikës me mbi 400.000 euro. "Banda përdorte metodë të caktuar vjedhjeje, përcaktimin shtëpinë pasdite dhe

natën persona të trajnuar hapnin dyer e dritare dhe rrëmbenin para dhe bizhuteri të shtrenjta", -thuhej në deklaratën për shtyp të policisë greke, pas arrestim-

it të grupit kriminal. Mediat e huaja bëjnë me dije se shqiptarët hajdutë janë të specializuar në alpinizëm -kacavjerrje dhe kështu arrinin të hapnin shtëpi të pallateve shumëkatëshe". Tre të arratisurit do përballen dhe me akuzat e tregtisë së drogës pasi në shtëpinë e kapobandës u sekuestruan 18 kg kanabis dhe 3 peshore. Mësohet se policia greke është vënë në ndjekje të tyre, shqiptarët e arratisur nuk janë kapur. Mësohet se policia greke ka ndërmarrë një operacion të shkallë të gjerë për gjetjen e të arratisurve.

Rolet e anëtarëve, ish-efektivi i policisë, Engrid Hënaj siguronte transportin

Banda e grabitësve të kasafortave, GPS-i i makinave tradhtoi "skifterët"

Hetimi, grupi kriminal përdorte automjete të marra me qira

Pas goditjes së bandës kriminale që grabiste kasaforta në Tiranë, dhe vënies në pranga të pesë anëtarëve të grupit, të tjera detaje dalin në dritë. Kujtojmë se në pranga ranë shtetasit Saimir Kuçi, Elton Lika, Valmend Pelivani, Donald Ahmetaj dhe Engrid Hënaj. Mësohet se 31-vjeçari Hënaj, një ish-efektiv policie gjatë marrjes në pyetje nga grupi hetimor ka pranuar bashkëpunimin me grabitësit. Për sa i përket roleve të anëtarëve të bandës, dysohet se Hënaj cilësohej si njeriu që ka siguruar makinat që përdorehin për grabitje. Automjetet siguroheshin në një kompani në zonën e ish-Bilokut. Të arrestuarit përdornin disa makina midis tyre 2 të vjedhura një "Benz" dhe një "BMW" dhe makinat e tjera i merrnin me qira. Pikërisht GPS-i i makinave me qira ka ardhur në ndihmë të policisë për të identifikuar më mirë dhe për të arrestuar grupin që tmeronte Tiranën prej disa muajsh. Fillimisht para policisë, 5 të arrestuarit nuk kanë pranuar akuzat.

Kontrolli i GPS-ve të tyre, nga policia e Tiranës, çoi në dokumentimin grabitjeve nga të cilat 11 në Tiranë, 6 në Durrës, 1 në Kavajë dhe 2 në Berat. GPS e makinave të marra me qira përkonin vendndodhjen e bizneseve të grabitura. Ndërkohë shumica e grabitjeve kanë ndodhur në 2 vitet e fundit. Burime policore thanë se hetimi është zhvilluar me metoda speciale dhe se policia kishte marrë informacione mbi anëtarët e grupit ndërsa theksohet se grupi i strukturuar linte shumë pak gjurmë në vendin e ngjarjes. Gjithashtu, mësohet se një ndër provat e tjera që rëndon mbi bandën kriminale janë edhe disa karta telefonash celularë të këtij grupi, të cilat përputheshin me vendndodhjen e maki-



Pamje nga grabitjet e kasafortave



nave. Një tjetër provë e rëndësishme sipas hetuesve janë kampione të mbetjeve biologjike të gjetura nga ekspertët në vendin e ngjarjes.

Kujtojmë se ish-efektivi i policisë Engrid Hënaj ra në pranga, vetëm 3 javë pasi kishte lënë qelinë pas arrestimit në shkurt të një viti më parë për dekonspirimin e aksioneve të uniformave blu në Kavajë. Ndërkohë pjesë e grupit ishte edhe 27-vjeçari Valmend Pelivani, i njohur ndryshe si Gjon Pelivani. Kujtojmë ngjarjen e ndodhur mesditën e 16 shkurtit, rreth orës 12:30, në rrugën "Irfan Tomini", ku gjatë një konflikti të castit u plagosën me armë zjarri në këmbë shtetasit Renato Hoxha, 31 vjeç dhe Gjon Pelivani 27 vjeç. Në atë kohë policia u vu të kërkim të Florian Musait dhe djalit të tij, Arti Musai, i cili dyshohet për si autori i plagosjes. Paraprakisht u tha se personat janë përfshirë në një sherr brenda një lokali, e më pas kanë dalë jashtë ambienteve të lokalit ku janë konfliktuar deri në përdorimin e armëve. Gjon Pelivani ishte konfliktuar me pronarin e lokalit Florjan Musain. Në sherr e sipër është afurur edhe djali i Florjan Musait, Arti Musai. Ky i fundit ka qëlluar drejt Gjon Pelivanit disa herë, duke e lënë të plagosur. Nga të shtënata ka mbetur i plagosur aksidentalisht edhe kamerieri i lokalit. Ndërkohë në shënjestër të të shtënave ishte Gjon Pelivani. Policia dyshon se shkak i ngjarjes së rëndë mund të jetë një konflikti i castit, por nuk përjashtohet pista e konflikteve të vjetra të Pelivanit. Nga verifikimet e kryera, i riu rezultoi person me precedent penale. 27-vjeçari ka qenë i dënuar më parë për vjedhje. Ndërsa në vitin 2015, Pelivani, atëherë 24-vjeç, është plagosur me armë zjarri nga Gilmando Dani, shok i Emiljano Shullazit. Pelivani ka pasur konflikte me grupin e Shullazit, të cilat kanë arritur deri në përdorimin e armëve të zjarrit. Nuk dihet nëse ngjarja ka lidhje me të shkuarën e tij të errët. Gjithashtu, Valmend Pelivani është

hetuar dhe për plagosjen e policit Ermal Bregu, ngjarje kjo e ndodhur te ish-Parku i autobusëve në dhje-


tor 2017. Edhe pse është marrë në pyetje, Pelivani është lënë i lirë për mungesë provash.

HETIMI

Të arrestuarit përdornin disa makina, midis tyre 2 të vjedhura, një "Benz" dhe një "BMW", ndërsa makinat e tjera i merrnin me qira. Pikërisht GPS-i i makinave me qira i ka ardhur në ndihmë të policisë për të identifikuar më mirë dhe për të arrestuar grupin që tmeronte Tiranën prej disa muajsh. Fillimisht para policisë, 5 të arrestuarit nuk kanë pranuar akuzat.

Arrestohet 24-vjeçari nga Tirana, nën akuzë për dhunë ndaj nënës së tij

Një 24-vjeçar nga Tirana ka rënë në pranga e policisë, pasi akuzohet se ka dhunuar nënën e tij. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se bëhet fjalë për shtetasin me inicialet S.S. Ndërkohë, nëna e tij, shtetasja me inicialet M.S., 51 vjeçe, ka kërkuar edhe urdhërmbrojtje. "Më datë 18.06.2018, u arrestua në flagrancë shtetasi S.S., vjeç 24, banues në Tiranë, pasi në banesë, ka ushtruar dhunë fizike dhe psikologjike ndaj nënës M.S., vjeçe 51, banuese në Tiranë, të cilës iu plotësua kërkesë-padia për lëshimin e urdhrit të



mbrojtjes së menjëhershme. Materialet u referuan pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006. Për

masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare". Neni 130/a/1 i Kodit Penal, -thuhet në njoftimin e policisë.


Reagimi i prindërve të viktimës: Fituam një betejë, kërkojmë që drejtësia të vihet në vend

Vrasja e Marvi Mihalit për një karikues, rikthehet në burg Eugen Bitraj

Gjykata pranon kërkesën e prokurorisë, ndryshon akuza për 21-vjeçar

Ina Allkanjari

Gjykata e Tiranës ka pranuar ditën e djeshme kërkesën e prokurorisë për ndryshimin e masës së sigurisë për një tjetër të pandehur për vrasjen e Marvi Mihalit një vit më parë. Bëhet fjalë për 21-vjeçarit Eugen Bitraj, i cili akuzohet si bashkëpunëtor në krim. Trupa gjyquese vendosi që Bitraj duhet të qëndrojë në burg pas ndryshimit të akuzës nga moskallëzim krimi në vrasje e kryer në bashkëpunim. Dy ditë më parë organi i akuzës kërkoi ndryshimin e masës nga "detyrim paraqitje" në "arrest me burg" për 21-vjeçarit. Kujtojmë se së fundmi gjykata ndryshoi masën e sigurisë edhe për dy të rinjtë e tjerë, të cilët u liruan në datë 11 maj së bashku me Eugen Bitraj. Kridens Alla dhe Marsel Alla të akuzuar për moskallëzim krimi, u përballen para togave të zeza me akuzën e vrasjes në bashkëpunim. Vendimi i lirim të tyre për shkak të tejkalimit të afateve të



Viktima Marvi Mihalit

burgimit, solli reagimin e prindërve të viktimës, të cilët denoncuan në Prokurorinë e Krimeve të Rënda prokurorin e çështjes Artan Lulaj, dy gjyqtarët Bedri Qorri dhe Sokol Pasho

si dhe oficerin e policisë gjyqësore Kliton Zharri se kanë marrë rryshfet në këmbim të lirim të tre të rinjve. Menjëherë pasi mësoi lajmit e lirim të tyre nëna e Marvin Mihalit, në një

postim në "Fb" shkruajti se tre nga kriminelët që bashkëpunuan në vrasje dhe dhunuan trupin e djalit të saj, në momentet e fundit ndërsa djali jepte shpirt, prokurori Artan Lulaj, i etur për para i kishte liruar nga burgu pa e ditur askush. "Sot është një ditë e zezë për mua! Marvin tim ma vranë përsëri! Tre nga kriminelët që bashkëpunuan në vrasje dhe dhunuan trupin e tij, në momentet e fundit ndërsa djali jepte shpirt, prokurori monstër, vampirë, demoni, sharlatani, maskarai Artan Lulaj i etur për para, i kish të liruar nga burgu pa e ditur askush! O Zot, çfarë tmerr! Të shikosh vrasësit e birit të vetëm pa akuzë, të lirë në sallën e gjyqit dhe tek i shihja më dilte parasysh video e ngjarjes, shkelmat e tyre mbi trupin e djalit tim! Sa më e madhe se kaq duhet të jetë dhimbja? Dhe çfarë torturash të tjera duhet të kaloj! Më thoni o njerëz, çfarë duhet të bëj në këtë vend? Si do ta vendos drejtësinë? Ju lutem, më ndihmoni!" shkruan në profilin e saj Mira Mihalit, nëna e Marvin Mihalit. Disa javë më parë prindërit e Marvi Mihalit kërkuan ndryshimin e prokurorit nga Artan Lulaj të Gjergji Tako dhe ky i fundit rihapi hetimin. Me kërkesë të prokurorit Tako, gjykata pranoi vendosi ndryshimin e masës për tre të rinjtë. Pas këtij vendimi, nëna e viktimës, Mira Miha-

AKUZA

Trupa gjyquese vendosi që Eugen Bitraj duhet të qëndrojë në burg pas ndryshimit të akuzës nga moskallëzim krimi në vrasje e kryer në bashkëpunim. Dy ditë më parë organi i akuzës kërkoi ndryshimin e masës nga "detyrim paraqitje" në "arrest me burg" për 21-vjeçarit. Kujtojmë se së fundmi gjykata ndryshoi masën e sigurisë edhe për dy të rinjtë e tjerë, të cilët u liruan në datë 11 maj së bashku me Eugen Bitraj.

allëzim krimi' ndryshoi akuzën në "vrasje me paramendim e kryer në bashkëpunim", për tre të rinjtë. Për sa i përket padisë së ngritur nga familjarët e Marvi Mihalit për prokurorin dhe dy gjykatësit, vazhdojnë hetimet te Krimet e Rënda", u shpreh avokati mbrojtës Saimir Visha. Pas vrasjes së Marvi Mihalit, ranë në pranga 4 të rinj. Konkretisht Eugen Bitraj, Kridens Alla dhe Marsel Alla u akuzuan për moskallëzim krimi, ndërsa Devi Bitraj akuzohet për vrasje me paramendim. Më datë 11 maj gjykatësit Sokol Pasho dhe Bedri Qorri i liruan tre të rinjtë e akuzuar për moskallëzim krimi për shkak se kishin mbarruar afatet e paraburgimit. Kjo gjë ka sjellë irritimin e prindërve të viktimës, të cilët kanë kallëzuar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, prokurorin Artan Lulaj, dhe dy gjykatësit Sokol Pasho dhe Bedri Qorri. Pas reagimit të prindërve u ndryshua prokurori i çështjes dhe dosjen e mori në dorë Gjergji Tako, i cili kërkoi ndryshimin e masës së sigurisë për 3 të rinjtë e liruar. Ai kërkoi rikthimin e të rinjve në qeli dhe po ashtu ndryshimin e akuzës nga "moskallëzim krimi" në "bashkëpunëtor në vrasje" së bashku me Devi Bitra-

li u shpreh për "Gazeta Shqiptare" se shpreson që drejtësia të vihet në vend. "Fituam një betejë, gjykata dhe prokuroria vendosën që tre të liruarve t'u ndryshohet akuza nga "moskallëzim krimi" në "vrasje në bashkëpunim". Kërkojmë që ky vendim të mbahet dhe drejtësia të vihet në vend", u shpreh Mira Mihalit. Në lidhje me këtë situatë avokati mbrojtës i familjes Mihalit, Saimir Visha u shpreh për "GSH" se gjykata më në fund vendosi drejtësi. "Gjykata më në fund vendosi drejtësi, sepse nga mosk-

bashkëpunimi gjerman
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEITUNG

Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit

OPEN CALL FOR TENDER PREQUALIFICATION

- GENERAL CONDITIONS**
- Requester:** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ), Office Tirana, Rr. Skenderbej No. 21/1
- Profile:** The project IPA/2017 "Countering Serious Crime in the Western Balkans" (IPA2017 CSC WB) supports since January 2017 the Public Prosecution Offices (PPO's), Ministries of Justice, Ministries of Interior and police in Albania, Bosnia and Herzegovina (BiH), Kosovo¹, Montenegro, Serbia and the former Yugoslav Republic of Macedonia. It is financed jointly by the European Commission and the Federal Ministry of Economic Cooperation and Development (BMZ) and implemented by the GIZ, Italian Ministry of Interior and the Center for International Legal Cooperation (CILC Netherlands). The overall objective of the project is to improve the overall security in the Western Balkans and the EU by combating organized crime and terrorism. The specific objective of the Action is to raise the effectiveness of and cooperation among regional and national capacities in tackling occurring forms of Serious Organized Crime (SOC), including the recovery of illegal financial gains obtained through diverse types of cross-border crime and the fight against illegal migrant smuggling.
- Subject:** The objective of the present call is for selecting potential institutions and legal persons to provide training in English language with a focus on Legal English and specific English terminology used by state authorities in charge with fight against serious and organised crime. The courses will have to be provided to members of staff from GIZ partner institutions in Albania the IPA2017 CSC WB project including the State Police, the Serious Crime Prosecution Office (including the District Prosecution Offices of Tirana and Durres), the Ministry of Justice, and the Ministry of Interior. The selected provider should be able to provide teaching at the premises of beneficiary institutions in Tirana and Durres for the period September 2018 to November 2019 and is expected to coordinate and harmonize its work with the IPA2017 CSC WB partner institutions.
- Eligibility:** Participation is open to all legal persons (participating either individually or in a grouping — consortium — of tenderers) which are effectively established in Albania.

All legal entities interested in the application process should ask for [application forms](#) to the address: giz-albanien@giz.de

2. The **due date** for submitting the application is **6 July 2018**. The documents should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification: Provision of Special English Language Course Focused on Legal and Similar Terminology in Use by Crime-Fighting State Authorities" to:

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)
Office Tirana, Rr. Skenderbej No. 21/1, Tirane

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow. The submitted applications will be evaluated and only prequalified candidates will be invited to answer the bid. All written communication for this procedure and the following successful ones must be in English.

(Footnotes)
¹This designation is without prejudice to positions on status and is in line with UNSCR 1244/1999 and the ICJ Opinion on the Kosovo Declaration of Independence.

United Nations Development Programme



TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: – RFP for ASSESSMENT OF CHALLENGES MUNICIPALITIES ARE FACING WITH SERVICE DELIVERY; CAPACITY BUILDING ON SERVICE DELIVERY, AND RE-ORGANIZATION OF SELECTED SERVICES

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked **UNDP/RFP 47196**

"RFP for ASSESSMENT OF CHALLENGES MUNICIPALITIES ARE FACING WITH SERVICE DELIVERY; CAPACITY BUILDING ON SERVICE DELIVERY, AND RE-ORGANIZATION OF SELECTED SERVICES"

For more details please refer to the link below:
<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement/>

Relevant dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than **20-Jul-18**

Address for communications:
Email: procurement.al@undp.org
Or
Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2nd floor
Tirana, Albania

Policia sekuestron kamerat e sigurisë afër vendit të ngjarjes, ende asnjë i dyshuar

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Një ditë pas vrasjes misterioze të pronarit të servisit të makinave, Mehdi Kavaja, policia e Shkodrës ka zbardhur detaje të reja në lidhje me këtë ngjarje të rëndë që ndodhi lagjen "Tophanë" (ose "Salo Halili") të këtij qyteti. Burime nga grupi hetimor dhe bënë me dije se 60-vjeçari ndodhej në servisin e tij duke punuar si zakonisht për riparimin e dorezave të makinave, kur papritur një person e ka qëlluar atë pas koke me pistoletë, duke e lënë të vdekur në vend. Fillimisht u mendua se Kavaja ka pasur hemorragji, por vetëm pas një ore, pas kryerjes së ekspertizës, mjekët arritën të konstatojnë një vrimë në kokën e tij si dhe një plumb në thellësi të kokës. Që në momentet e para policia ka shkuar në vendngjarje dhe ka nisur hetimet mbi këtë vrasje të ndodhur në rrethana misterioze. Burimet e mësipërme pohuan se dyshohet që ekzekutimi i 60-vjeçarit të ketë marrë shkas për disa konflikte që kanë të afërmit e tij prej vitesh. "Vrasja mendohet se mund të jetë një hakmarrje për ngjarje të ndodhura para shumë viteve, ku dyshohet se kanë qenë të përfshirë të afërmit të shtetasit Mehdi Kavaja", thanë burimet policore për "Gazeta Shqiptare". Por, për policinë ende gjithçka mbetet në kuadër të dyshimeve. Ndërkohë, të njëjtat burime pohuan se viktima mund të jetë ekzekutuar nga vrasës me pagesë. Kjo, nisur nga mënyra se si është kryer vrasja, e cila mësohet të ketë qenë e sofistikuar dhe e mirëmenduar. Megjithatë, kjo është vetëm njëra prej pistave të momentit që po heton policia vendore e Shkodrës, ndërsa nuk përjashtohet edhe ndonjë mundësi tjetër: Pasi është konstatuar nga ekspertiza mjeko-ligjore se pronari i servisit ishte vrarë dhe nuk kishte pësuar hemorragji, policia ka sekuestruar kamerat e sigurisë së subjekteve afër vendit të ngjarjes. Nga këyryra e deritanishme nuk ka asnjë person konkret të dyshuar. Në fakt, jo e gjithë zona ka kamera sigurie dhe dyshohet se autori e ka studiuar mirë terrenin më përpara për të arritur më pas tek ky ekzekutim, që për nga mënyra, për policinë është një vrasje e rangut profesionist. Askush nuk e ka parë autorin e krimin, ndërsa nuk është dëgjuar asnjë zhurmë nga familjarët apo komshinjtë, pavarësisht se vrasja është bërë me pistoletë. Ka qenë një kalimtar i rastit që ka parë të shtrirë në tokë dhe të gjakosur 60-vjeçarin dhe menjëherë ka njoftuar ambulancën. Vrasja ndodhi rreth orës 15:30 të së hënës në lagjen "Tophanë", aty ku Mehdi Kavaja punonte prej shumë vitesh në servis të riparimit e dorezave të mjeteve. Ndërkohë, policia dhe prokuroria e Shkodrës vijojnë hetimet për zbardhjen e plotë të kësaj ngjarjeje.

Ekzekutimi i pronarit të servisit, policia: Autori, vrasës me pagesë

Hakmarrje për shkak të ngjarjeve të vjetra, ku janë përfshirë të afërmit e 60-vjeçarit



Viktima Mehdi Kavaja



Vendi ku ndodhi vrasja

HAKMARRJA

Burimet policore pohuan për "Gazeta Shqiptare" se dyshohet që ekzekutimi i 60-vjeçarit të ketë marrë shkas për disa konflikte që kanë të afërmit e tij prej vitesh. "Vrasja mendohet se mund të jetë një hakmarrje për ngjarje të ndodhura para shumë viteve, ku dyshohet se kanë qenë të përfshirë të afërmit të shtetasit Mehdi Kavaja", thanë burimet nga policia.

VRASJE ME PAGESË

Sipas hetuesve të çështjes, viktima mund të jetë ekzekutuar nga vrasës me pagesë. Kjo, nisur nga mënyra se si është kryer vrasja, e cila mësohet të ketë qenë e sofistikuar dhe e mirëmenduar. Megjithatë, kjo është vetëm njëra prej pistave të momentit që po heton policia vendore e Shkodrës, ndërsa nuk përjashtohet edhe ndonjë mundësi tjetër.

Droga u gjet afër banesës së 20-vjeçarit në kërkim

Operacioni "West Univers", policia dhe FNSH sekuestrojnë 114 kg kanabis në qytetin e Lezhës



SHKODËR - Policia e Lezhës në bashkëpunim me atë të Shkodrës, në kuadër të operacionit të koduar "West Univers" dhe kanë gjetur edhe 114 kg të tjera kanabis sativa, duke e çuar në total në 314 kg drogën e sekuestruar. Mbrëmjen e së premtes që shkoi, blutë sekuestruan gjatë këtij operacioni edhe 200 kg kanabis, ndërsa vumë në pranga 6 persona si dhe shpallën në kërkim 2 të tjerë. Mësohet se sasia prej 114 kg drogë u gjet pas kontrolleve të ushtruara nga policia e Shkodrës dhe e Lezhës, të mbështetura nga forcat speciale të FNSH-së. Lënda narkotike u sekuestrua në lagjen "Nënë Tereza" në qytetin e Lezhës, në afërsi të banesës së 20-vjeçarit S.N., i cili është shpallur në kërkim. Sipas burimeve policore, në oborrin e shtëpisë së të kërkuarit u gjet edhe një automjet tip furgon, brenda të cilit kishte mbetje

lënde narkotike. Dyshohet se ky mjet është përdorur për transportimin e kanabisit në destinacione të ndryshme. Operacioni "West Univers", sipas policisë do të vijojë për kapjen dhe ar-

restimin e të gjithë personave të implikuar në këtë aktivitet kriminal. Gjykata e Shkallës së Parë në Shkodër dhe dy ditë më parë masën e sigurisë "Arrest me burg" për 6 të arrestuarit, të cilët u

kapën pranë vendit të quajtur kompleksi "Univers", në afërsi të Laçit, pas dyshimeve se ata po shkëmbejnë sasinë prej 200 kg kanabis. Bëhet fjalë për shtetasit Ardit Haxhagici, 34 vjeç nga Shkodra; Fatbardh Gostini, 37 vjeç nga Lezha; Neritan Saraçi, 51 vjeç nga Shkodra; Rezart Çarçani, 34 vjeç nga Shkodra; Ramadan Dushaj 61 vjeç nga Malësia e Madhe dhe Vilson Noka, 27 vjeç nga Lezha. Gjatë seancës gjyqësore, 6 të pandehurit kanë mohuar të kenë lidhje me sasinë prej 200 kg lëndë narkotike. Ata u shprehën se kanë rënë në grackën e policisë, pasi sepse kishin shkuar për t'u marrë vesh për tregtimin e produkteve bujqësore dhe jo për drogë siç akuzohen.

SHKURT

Tentuan të trafikojnë drogë në Greqi, arrestohen 2 të rinj

KORÇË - Policia e Kapshiticës ka arrestuar dy të rinj, pasi kanë tentuar të kalojnë në kufi rreth 21 kg kanabis. Bëhet fjalë për shtetasit Adriatik Rasa, 26 vjeç, banues në Lushnjë dhe Besart Skënderasi, 28 vjeç, banues në Vloçisht-Korçë. Arrestimi i tyre u bë në afërsi të fshatit Kapshiticë-Devoll, në vendin e quajtur "Lugina e vogël", pasi shërbimet policore të patrullës së kufirit të gjelbër iu gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale brenda një çante, një sasi prej 21 kg e 400 gr lëndë narkotike, të cilën synonin ta trafikonin drejt Greqisë. Ndërkohë, po punohet për identifikimin dhe kapjen e bashkëpunëtorëve të tjerë, të dyshuar si të implikuar në këtë ngjarje.

Kryente veprime të turpshme në publik, kapet 53-vjeçari

BULQIZË - Një 53-vjeçar është prangosur nga policia e Bulqizës, pasi ka kryer veprime të turpshme në publik si dhe ka kundërshtuar me dhunë punonjësit e policisë gjatë shoqërimit për në komisarjat. I arrestuar është shtetasi Haqif Dishmuça, banues në Burrel (i dënuar më parë për mosbindje ndaj urdhrave të punonjësit të policisë së rendit publik). Materialet procedurale i ka kaluan Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Dibër për veprat penale "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik", "Goditje për shkak të detyrës", "Mosbindje ndaj urdhrave të punonjësit të policisë së rendit publik", "Prishja e qetësisë publike" si dhe "Vepra të turpshme".

Parcelat me drogë, një në pranga dhe një nën hetim

SARANDË/ VLORË - Policia e Sarandës ka zbuluar një parcelë me drogë në fshatin Vergo të Delvinës. Lënda narkotike u gjet në vendin e quajtur "Sinanaj", ku u zbuluan dhe u asgjëruan 265 bimë narkotike kanabis sativa. Ndërkohë, në pranga ka përfunduar Vasil Nune nga Novosela, bari i zonës. Mësohet se 61-vjeçari është kapur me 12 kg marijuanë në vitin 2015. Po asje, policia e Vlorës ka asgjësuar 300 bimë kanabis në vendin e quajtur Pylli i Akërnisë. Për këtë rast është proceduar 47-vjeçari me iniciale VM., me detyrë roje mjedisi në A.K.Z.M.



Policia në vendin ku ndodhi shpërthimi me tritol



Policia: 47-vjeçari, objektivi i autorëve. Ngjarja, për shkak të detyrës si inspektor zone

Tronditet Shkodra, sulmohet me eksploziv automjeti i efektivit të policisë

Shpërthimi, para banesës. Agim Bushgjoka, kolegëve: Nuk kam probleme dhe konflikte me askënd

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Një shpërthim me tritol ka tronditur banorët e qytetit të Shkodrës. Mësohet se persona ende të paidentifikuar kanë vendosur eksploziv në makinën e një efektivit të policisë, Agim Bushgjoka. 47-vjeçari ndodhet në shtëpinë e tij kur ka ndodhur shpërthimi në automjetin në pronësi të tij, që ishte i parkuar poshtë pallatit ku banon. Si pasojë e shpërthimit të lëndës plasëse janë shkaktuar vetëm dëme materiale. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Shkodrës bënë me dije se ngjarja ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të djeshëm, në vendin e quajtur "Mëhalla e Re". Menjëherë në vendngjarje kanë shkuar blutë, të cilët kanë nisur hetimet për zbardhjen e plotë të rrethanave të kësaj ngjarjeje. Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprake, hetuesit e çështjes pohan se objektivi i sulmit me tritol ishte kolegu i tyre. Ndërkaq, Agim Bushgjoka, me detyrë polic zone në fshatrat Bardhaj dhe Grudë të njësisë administrative Rrethina të Bashkisë Shkodër ka deklaruar gjatë marrjes në pyetje se nuk ka konflikte me askënd.

NGJARJA

Sipas burimeve policore, në momentin e shpërthimit të tritolit, në makinë nuk ka qenë askush. Rezultoni se nga sulmi me eksploziv, automjeti i policit Agim Bushgjoka ka pësuar një dëm të konsiderueshëm në pjesën e poshtme duke e nxjerrë momentalisht jashtë funksionit. Menjëherë në vendngjarje kanë mbërritur forcat e policisë, të cilët kanë gjetur aty kolegun e tyre, në mëntin e të cilit u vendos sasia e tritolit. Sipas dëshmitëve të ndryshme ka qenë një shpërthim i fuqishëm, që është dëgjuar edhe në disa lagje në largësi nga fillimi i unazës lindore në vendin e quajtur "Mëhalla e Re" ku ndodhi ngjarja. Menjëherë Bushgjoka ka dalë për të parë se çfarë ka ndodhur, duke qenë

HETIMI
Shpërthimi me tritol në automjetin e efektivit Agim Bushgjoka ka alarmuar policinë e Shkodrës, e cila po punon intensivisht për identifikimin dhe vënien në pranga të autorëve të krimin. Sipas hetuesve të çështjes, dyshohet se sulmi ndaj kolegut të tyre të ketë ndodhur për shkak të detyrës së tij si polic zone (SPZ) në fshatin Bardhaj dhe Grudë të njësisë Rrethina.



Makina e efektivit të policisë e dëmtuar nga tritolit

edhe punonjës policie, por ka parë se ishte një ngjarje që lidhej me të dhe se lënda plasëse ishte vendosur në mjetin e tij. Mësohet se 47-vjeçari nuk ka arritur të identifikojë asnjë person si autor të mundshëm, sepse ata janë larguar me shpejtësi. Pasi kanë vendosur tritolin poshtë makinës dhe kanë realizuar shpërthimin, autorët e krimin kanë arritur që të largohen pa lënë gjurmë. Nga veprimet e para, rezultoni se është një ngjarje e qëllimshme dhe se objektivi ka qenë efektivit Agim Bushgjoka. Megjithatë, policia ende nuk ka më shumë informacion se kush mund të jenë autorët e kësaj ngjarjeje. Sipas hetuesve të çështjes, vendi ku ka ndodhur shpërthimi nuk ka kamera sigurie, ndërsa edhe subjektet e tjera aty afër nuk kanë kamera sigurie. Mungesa e kamerave të sigurisë ia vështirëson punën policisë, duke qenë se është e pamundur të shihen

lëvizjet dhe autorët e mundshëm që kanë vendosur eksplozivin në automjetin e policit Agim Bushgjoka. **DËSHMIA E POLICIT**
Efektivit Agim Bushgjoka menjëherë pas shpërthimit me tritol ka dhënë dëshminë e tij për kolegët, grupin hetimor të policisë vendore të

Shkodrës. Ai ka mohuar se ka probleme me persona të tjerë, ndërsa është shprehur se nuk ka ndonjë ide se përse mjeti i tij është sulmuar me tritol. Për policin e Shkodrës, kjo ngjarje është e çuditshme duke qenë se pretendon se nuk është i përfshirë në ndonjë konflikt

të mundshëm. "Nuk e kam idenë përse ka ndodhur. Unë nuk kam ndonjë problem me ndokënd. Nuk kam as ndonjë konflikt, ndaj nuk e di përse ka ndodhur. Unë dola për të parë se çfarë kishte ndodhur, kur pashë se ishte dëmtuar makina ime. Kam mbetur i çuditur nga kjo

ngjarje", ka deklaruar Bushgjoka. Pavarësisht kësaj dëshmie, policia vijon hetimet, ndërsa pistë kryesore për momentin është se Agim Bushgjoka mund të jetë sulmuar për shkak të detyrës që ka si polic zone (SPZ) në fshatin Bardhaj dhe Grudë të njësisë Rrethina.

DEKLARATA

Për policin e Shkodrës, kjo ngjarje është e çuditshme duke qenë se pretendon se nuk është i përfshirë në ndonjë konflikt të mundshëm. "Nuk e kam idenë përse ka ndodhur. Unë nuk kam ndonjë problem me kënd. Nuk kam as ndonjë konflikt, ndaj nuk e di përse ka ndodhur. Unë dola për të parë se çfarë kishte ndodhur, kur pashë se ishte dëmtuar makina ime. Kam mbetur i çuditur nga kjo ngjarje", ka deklaruar Bushgjoka.

KUKËS - Gjykata e Kukësit ka liruar nga burgu edhe tre protestuesit e fundit të tubimit të dhunshëm të 31 marsit të këtij viti kundër tarifës për Rrugën e Kombit. Togat e zeza të këtij qyteti dje lanë të lirë Xhevahir Gashin, ndërsa pak ditë më parë u lirua për arsye shëndetësore Florin Onuzi. Mësohet se sot mbaron afati i paraburgimit për 39-vjeçarin Elton Cengu dhe 31-vjeçarin Vasil Laçi. Pas protestës, fillimisht u arrestuan 23 persona. Disa prej tyre u liruan nga Gjykata e Shkallës së Parë e Tiranës,

Tubimi i dhunshëm në Rrugën e Kombit, Gjykata e Kukësit liron tre protestuesit e fundit



ndërsa disa të tjerë nga Gjykata e Apelit në Shkodër. Së fundmi, Gjykata e Kukësit ku u rikthe çështja ka liruar 3 protestuesit e fundit. Në vendimin e Gjykatës së Kukësit është firmosur marrëveshja e fajësisë për 16 nga 23 personat e hetuar, një pjesë e tyre janë gjobitur, ndërsa të tjerët janë në shërbim prove pas lirimit nga burgu dhe shuarjes së të gjitha

masave. Rreth dy muaj e gjysmë nga protesta e dhunshme në Rrugën e Kombit, nga sot nuk do të ketë asnjë të ndaluar, pasi të gjithë protestuesit janë liruar nga gjykata, ndërsa në shtator pritet që të futet në fuqi tarifa për të kaluar në Rrugën e Kombit me shumë lehtësi për banorët e Kukësit nga hera e parë që ishte planifikuar 5 euro për kalim.

Manastirliu prezanton ndryshimet në Kuvend: Forcojmë ligjin, mbrojtje për fëmijët

Voltiza Duro

Në katër muajt e parë të këtij viti janë evidentuar plot 1780 raste dhune dhe krime të tjera në familje. Këto shifra kanë sjellë reagimin e ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, e cila dje ka propozuar ndryshimet në ligjin kundër dhunës ndaj grave. "Vetëm në 4 muajt e parë të këtij viti janë evidentuar 1780 raste dhune dhe krime të tjera në familje. Për të përafëruar legjislacionin shqiptar me standardet më të mira ndërkombëtare, por mbi të gjitha, në përgjigje të rasteve të shtuara të denoncimit të dhunës në familje, në disa raste me pasojë tragjike, propozojmë ndryshime thelbësore në ligjin 'Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare', për të garantuar mbrojtjen e strukturës së familjes nga dhuna", tha Manastirliu gjatë prezantimit të ndryshimeve ligjore në Komisionin e Ligjeve në Kuvend. Kështu ligji për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare do të parashikojë urdhrin paraprak të menjëhershëm të mbrojtjes për viktimat e dhunës, duke garantuar mbrojtje për gratë e që përballen me dhunën në familje, që në momentin e parë të denoncimit në polici.

URDHRIT
"24 orët e para pas denoncimit të dhunës janë shpesh vendimtare për gratë që përballen me dhunën në familje ndaj ne propozojmë aktivizimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes nga Policia e Shtetit, deri në konfirmimin e tij nga gjykata", - u shpreh Manastirliu.

tomatikisht do të garantohet urdhrin e mbrojtjes për fëmijët, edhe nëse mbi ta nuk është ushtruar dhunë e drejtpërdrejtë", - u shpreh ministrja. Duke theksuar

NDRYSHIMET NË LIGJ

Këto ndryshime të propozuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale synojnë të plotësojnë boshllëqet që kishte ligji i mëparshëm për masat emergjente të mbrojtjes. "24 orët e para pas denoncimit të dhunës janë shpesh vendimtare për gratë që përballen me dhunën në familje ndaj ne propozojmë aktivizimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes nga policia e shtetit, deri në konfirmimin e tij nga gjykata" - u shpreh Manastirliu. Një tjetër risi në ligj është zgjerimi i mbrojtjes përtej marrëdhënies juridike burrë-grua, duke parashikuar masa të mbrojtjes për gratë dhe vajzat që bashkëjetojnë apo janë në lidhje afektive. "Ky është një ligj për gjeneratat e ardhshme, sepse mbron jo vetëm bashkëshortet por edhe gratë dhe vajzat që janë në lidhje afektive dhe kanë njësoj nevojë për mbrojtje, siç e kanë treguar edhe rastet e fundit tragjike", tha Manastirliu. Më tej kjo e fundit u ndal edhe tek ndryshimet ligjore që garantojnë një mbrojtje më të mirë për fëmijët që asistojnë dhunës në familje. "Ndryshimet që ne propozojmë, janë ndryshime që përmirësojnë mbrojtjen e fëmijëve, pasi për herë të parë, me urdhrin e mbrojtjes për nënën, au-

tomatikisht do të garantohet urdhrin e mbrojtjes për fëmijët, edhe nëse mbi ta nuk është ushtruar dhunë e drejtpërdrejtë", - u shpreh ministrja. Duke theksuar



Ogerta Manastirliu dje në Komisionin e Ligjeve në Kuvend

rëndësinë e ndryshimeve të propozuara, Manastirliu ftoi deputetët të bëhen bashkë për miratimin e tyre, në mënyrë që të forcohet sistemi që parandalon fenomenin e dhunës në familje. Nisma për ndry-

shimet në ligjin ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare u ndërmor nga Manastirliu pak javë pas marrjes së detyrës si ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ndryshimet në ligjin ndaj dhunës në marrëdhëni-

et familjare parashikojë afate të qarta procedurale, duke filluar që nga regjistrimi i kërkesës e deri te ankimet për vendimet gjyqësore, me qëllim që sidomos urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes të dalin pa asnjë vonesë dhe të sigurojnë viktimit nga rreziku imediat. Në ndryshimet ligjore të propozuara, parashikimi shprehimisht edhe detyrimi i organeve shtetërore për të ofruar falas, çdo shërbim ekspertize për rastet e dhunës në familje. Ndryshimet ligjore synojnë parandalimin dhe reduktimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe në njësinë shërbimtare, për të garantuar mbrojtje të veçantë dhe pa diskriminim të çdo grupi që paraqet nevojë të veçanta mbrojtjeje.

"Ndryshimet që ne propozojmë, janë ndryshime që përmirësojnë mbrojtjen e fëmijëve, pasi për herë të parë, me urdhrin e mbrojtjes për nënën, automatikisht do të garantohet urdhrin e mbrojtjes për fëmijët, edhe nëse mbi ta nuk është ushtruar dhunë e drejtpërdrejtë", u shpreh ministrja.

Dokumentacioni që duhet të dorëzoni brenda 10 korrikut

Bursa në Sllovaki për studentët e Universitetit të Tiranës, kriteret



APLIKIMI

Studentët e nivelit bachelor që janë të interesuar të fitojnë bursën 4-mujore në Universitetin Comenius në Sllovaki, duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës gjatë aplikimit. Ata duhet të dorëzojnë një CV në gjuhën angleze, një kopje të pasaportës, vërtetim studentit si dhe një listë notash.

njoftimin e Universitetit të Tiranës.

APLIKIMI

Studentët e nivelit Bachelor që janë të interesuar të fitojnë bursën 4 mujore në Universitetin Comenius në Sllovaki, duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës gjatë aplikimit. Respektiv-

isht, ata duhet të dorëzojnë një CV në gjuhën angleze; një kopje e Pasaportës; vërtetim studentit si dhe një listë notash. Gjithashtu, kandidatët duhet të dorëzojnë edhe një letër motivimi në gjuhën angleze; certifikatën e gjuhës së huaj (Anglisht B1/ B2 në varësi të pro-

gramit të studimit); si dhe të ashtuquajturën "Learning Agreement". Studentët duhet të kenë kujdes që gjatë aplikimit, të përzgjedhin lëndë të njëjta me ato që do të kryenin në semestrin e parë në fakultetin e Universitetit të Tiranës, në mënyrë që lëndët dhe kreditet të njihen kur të kthehen. Ndërkohë, të gjithë studentët që vazhdojnë studimet master e dëshirojnë që semestrin e parë të vitit akademik 2018-2019 ta kryejnë në universitetin e Bratislavës në Sllovaki, duhet të paraqesin dokumentacionin brenda afateve të përcaktuara. Kështu, kandidatët duhet të

MBULIM 700 EURO NË MUAJ

Këto bursa studimi mbulojnë kompensimin prej 700 euro në muaj për studentët si dhe kostot e udhëtimit, kjo në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës. Studentët që përfitojnë nga mobiliteti nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës.

dorëzojnë një CV në gjuhën angleze; një kopje të Pasaportës; vërtetim studentit; diplomën e nivelit Bachelor ku duhet t'i bashkëngjitet lista e notave. Gjithashtu, aplikanti duhet të dorëzojë edhe një listë notash të nivelit master të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze si dhe një letër motivimi e një certifikatë të gjuhës së huaj. Ashtu si në nivelin bachelor, studentët duhet të paraqesin kontratën "Learning Agreement".

Voltiza Duro

VIP

Suplement
Pages

E mërkurë 20 Qershor 2016 GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- Aleksandër Meksi 79 vjeç. Ish-kryeministri, krah dy nipave
- Ish-deputeti, dedikim gruas: Gjithë ditën mendova për dhuratën
- Seehofer, për Merkelin: Me këtë grua s'mund të punoj!
- Për Vuçiç, Kupa e Botës është më e rëndësishme se Kosova


Trëndafila të kuq dhe
ëmbëlsira, kush e surprizon
Fjolla Morinën?



Provokon keq
Dafina Zeqiri,
fut dorën në vend intim



Nga Aurela Gaçe, tek Rudina Dembacaj,
ja destinacionet e të famshmeve




Diell, det dhe dëshirë për relaks,
cilët janë VIP-at që nisën
pushimet të parët për këtë vit

Nga Aurela Gaçe, tek Rudina Dembacaj, ja destinacionet e të famshmëve

Diell, det dhe dëshirë për relaks, cilët janë VIP-at që nisën pushimet të parët për këtë vit

Pamela Aliaj

Tashmë jemi në fund të qershorit dhe, edhe pse temperaturat nuk janë shumë premuese për të nisur plazhin, shumë prej VIP-ave tanë i kanë nisur tashmë pushimet. Nuk kemi sesi t'i përfshijmë të gjithë, sepse padyshim që të gjithë janë të predispozuar, kush me vetëm një fundjavë e kush me pushime të plota, të shijojë rrezet e diellit. Por në listën tonë janë shkëputur disa që kanë copëzat më të veçanta për të hapur siparin e pushimeve për këtë verë.




ALKETA VEJSIU, "HAKUNA MATATA" NGA AFRIKA

Pas një sezoni të ngjeshur duke moderuar njëri pas tjetrit emisione të ndryshme, Alketa Vejsiu ka vendosur të nisë pushimet. Kësaj radhe, ndryshe nga VIP-at e tjerë, moderatorja e "Në kurthin e Piter Pan", ka vendosur të shijojë Afrikën e egër. Nga fotot e postuara në "Instastory", Alketa shfaq një pjesë nga parajsa afrikane ku ka vendosur të kalojë pushimet si fillim vere. Një mrekulli e vërtetë!

RUDINA DEMBACAJ, PUSHIME PËRRALLORE NË TURQI

P prej më tepër se një javë, aktorja e njohur Rudina Dembacaj ka nisur pushimet së bashku me familjen në një nga resortet fantastike të Turqisë. Edhe pse me pushime, nuk ka hezituar të postojë foto nga resorti dhe nga momentet e bukura që po kalon me familjen e saj dhe në veçanti me vogëlushen e saj, që tashmë ka nisur të ecë, Viktorian.




AURELA GAÇE SË BASHKU ME FAMILJEN, MOMENTE TË PAHARRUESHME



Pas një periudhe aq të ngjeshur netësh 'live', më në fund këngëtarja e njohur, Aurela Gaçe ka nisur pushimet së bashku me familjen e saj. Ajo ka vendosur të ndajë disa momente të ëmbla edhe në rrjetet sociale, duke treguar se sa të rëndësishme dhe të nevojshme ishin këto pushime për të gjithë. Edhe pse 18 muajshe, Abigail tashmë ka nisur të ecë dhe në një foto duket shumë e turpshme kur mami Aurela tenton ta fotografojë. "Edhe kjo mami, më çmendti me foto!", ka shkruar në një nga fotot e postuara këngëtarja në "Instagram". Momente me familjen, më të çmuara nuk ka!


ALBAN RAMOSAJ, SË BASHKU ME ORIOLA MARASHIN? PUSHIME APO PUNË?



Pas publikimit të këngëve të tij të albumit "Hiraeth", kanë nisur pushimet, mbase jozyrtarisht, për këngëtarin Alban Ramosaj. Ai ka postuar së fundmi një foto nga resorti në Turqi ku po pushon. Edhe pse koha është pak e vrenjtur, pamja duket fantastike e shkrepur nga ballkoni i hotelit. Por ajo që na bën përshytyje është se ky resort është i njëjti me atë ku ndodhet bukurshja Oriola Marashi.



AURELA HOXHA, SEKSI NË RROBA BANJOT E LINJËS SË SAJ



Ajo njihet për shijen e veçantë në veshje edhe së fundmi kurorëzoi edhe një ndër pasionet e saj. Aurela Hoxha nxori në treg linjën e vet të rroba banjave, provokuese dhe të ëmbla në të njëjtën kohë. Duke qenë se jemi në një periudhë vere, "show girl"-i arrin t'i bëjë të dyja, edhe pushimet, edhe reklamimin e tyre. Duke qenë se s'ka një destinacion të caktuar, Aurela nuk harron të postojë foto me rroba banjo seksi në vendet e ndryshme që viziton.




MIRIAM DHE AMELI SHIJOJNË DITËT E PARA TË PLAZHIT

Këngëtarja e njohur Miriam Cani duket se ka nisur sezonin e plazhit. Gjatë ditës së sotme, ajo ka publikuar në rrjete sociale një foto ku shfaqet me vajzën e saj, Ameli. Duket se nënë e bijë janë duke u relaksuar dhe shijuar rrezet e diellit si dhe detin.



ORIOLA MARASHI EDHE PUNË, EDHE PUSHIME NË TURQI



Mund të themi me siguri që ajo është një ndër modelet më me fat të momentit. Modelja Oriola Marashi ka ndarë për fansat një foto nga seti më i ri fotografik, ku përveç punës, shijon edhe pushimet. Në një foto të publikuar në "Instastory", Oriola po kalon momente relaksi, përveçse pune në një nga resortet e Turqisë. Ajo ka përfunduar para disa ditësh një 'fotoshooting' në jug të Shqipërisë, në Vlorë, ku e veshur me një palë rroba banje dukej shumë provokuese dhe sensuale si gjithnjë.

ANA LIKA PROVOKON ME FOTO TOPLES NGA BALLKONI

Ajo njihet për karakterin e saj të veçantë dhe shpërthyes. Aktorja shqiptare, Ana Lika ka realizuar disa foto sensuale dhe njëkohësisht shumë të guximshme. Ajo tashmë ka nisur pushimet së bashku me shoqet e saj të pandara, Kejvina Kthella dhe Sabina Shehu. Nderkohë, që Einxhel Shkira nuk i është bashkuar grupit për momentin. Në "Instagram", ditët e fundit aktroja ka realizuar disa foto që kanë tërhequr vëmendjen e të gjithëve. Ajo është shfaqur topless në majë të një ballkoni në Tiranë për të realizuar këto foto. "Ti akoma vazhdon kërkon për mua tek çdo femër" mbishkruhet në foto. Më pas, të tjerat ishin edhe më sensuale edhe pse ajo kishte denjuar të hidhte një peshqir sipër.




FJORI DARDHA, COPEZA PUSHIMI NË KSAMIL

Edhe pse zyrtarisht nuk mund të themi se ka nisur pushimet, një nga moderatorët e "Boom", Fjori Dardha, shfrytëzon fundjavat për të shijuar rrezet e diellit në jug të Shqipërisë. Jo të gjithë VIP-at parapëlqejnë të largohen për të shijuar verën dhe një ndër to është edhe Fjori, e cila parapëlqen të kalojë fundjavat në Ksamil.



NJË 'TIGËRESHË' SI KEJVINA KTHELLA

Jo vetëm Ana bën foto me bikini dhe provokuese. Mesa duket, vajzat janë fotografe të njëra-tjetrës. Në të njëjtin vend ku aktroja Anais Lika ka dalë me një palë rroba banjo rozë dhe një t-shirt të bardhë, ka dalë edhe velina e "Xing me Ermalin", Kejvina Kthella. E veshur me një palë rroba banjo me printime të lëkurës së tigrit, Kejvina duket shumë provokuese dhe sensuale.




LUANA VJOLLCA, PAK PUSHIM NË NICË TË FRANCËS

Pas publikimit të këngës në bashkëpunim me Bujar Qamilin, Luana vendosi më në fund të largohet nga vendlindja për t'i nisur pushimet jashtë këtë verë. Ka qenë pikërisht Nica e Francës, destinacioni i preferuar i këngëtares dhe moderatorës bukuroshe. Në një foto të postuar në "Instastory", ajo shfaq vendin ku relaksohet, rërë, det, diell dhe shumë njerëz. Por me siguri që ky është vetëm fillimi. Jemi duke pritur fotot që do të "ndezin" "Instagram"-in të Luanës me bikini.



AMARDA TOSKA, TURQIA DESTINACIONI I PREFERUAR I FAMILJES MAMAQI

Si vitin e kaluar, edhe këtë vit, familja e Samit dhe Ermal Mamaqit nisën pushimet në një nga resortet e Turqisë. Direkt me përfundimin e sezonit të "Xing me Ermalin", familja është nisur për të shijuar disa ditë relaksi jashtë vendit. Nuk janë të vetmit VIP-a që parapëlqejnë të zgjedhin Turqinë për të shijuar rrezet e diellit dhe relaksin e garantuar nën shoqërinë e familjes, edhe aktorja Rudina Dembacaj dhe këngëtarja Jonida Maliqi e zgjedhën si destinacion gjithashtu.



DORINA GEGICI, MODELJA SHIJON DIELLIN, POR SYRI NA SHKON TEK STRIJAT E SAJ

S'ka se si të mos të jetë ndër të parat që t'i fillojë pushimet modelja e njohur, Dorina Gegici. E ulur në rënë e nxehtë me një palë rroba banjo të kuqe, Dorina duket e ëmbël dhe seksi në të njëjtën kohë. Edhe pse është një ndër modelet më të njohura dhe të dashura në Shqipëri dhe jashtë vendit, ajo paska të njëjtin problem që kanë të gjitha vajzat. Nuk mundem se si të mos vinim re strijat që i duken në foton e shkrepur së fundmi. Edhe pse me linja perfekte, këtë verë Dorina është shfaqur ashtu siç është në të vërtetë. Prapë se prapë, ajo mbetet një ndër modelet më të kërkuara në vend e më gjerë.



TRËNDAFILA TË KUQ DHE ËMBËLSIRA, KUSH E SURPRIZON FJOLLA MORINËN?

Nuk është hera e parë që e surprizojnë nëpër hotelet që ajo shkon për koncertet e ndryshme muzikore. Kësaj radhe kanë preferuar që Fjolla Morinë t'i sjellin një zemër të madhe, të mbushur me trëndafila të kuq dhe ëmbëlsira. "Kush, kush", shkruan në fotot e postuara në 'Instastory' të shoqëruar me një fytyrë në formë zemre. Kjo do të thotë që këngëtarja e ka ditur se nga vjen një surprizë e tillë edhe pse ka dashur ta mbajë 'sekret' nga ndjekësit e saj. Me siguri është partneri i Fjollës që ka preferuar ta surprizojë me një gjest të tillë romantik në hotel.



NËN GJURMËT E ALBANIT, JA PASIONI I DJALIT TË ÇILJETËS

Edhe më parë e ka deklaruar në një intervistë të mëparshme që djali i saj, Alehandro, parapëlqen dhe ka pasion futbollin. Ndërkohë që kohët e fundit ajo ka postuar në llogarinë e saj në 'Instastory' një pjesë nga stërvitja e vogëlushit në futboll, i cili ishte i shoqëruar edhe nga trajneri i tij. Mesa duket Alehandro do të ndjekë gjurmët e partnerit të së ëmës, portierit të Partizanit, Alban Hoxha. E ku ka më bukur, të shohim një futbollist të ardhshëm bukurorsh si Alehandro i Çiljetës?



PROVOKON KEQ DAFINA ZEQIRI, FUT DORËN NË VEND INTIM

Edhe pse është shpërngulur prej kohësh në SHBA, këngëtarja Dafina Zeqiri vijon të jetë aktive në rrjetet sociale. Kohët e fundit ajo shihet e veshur shumë sportive ndërsa në bluzë e ka figurën e 2Pac-ut. Por ajo që bie në sy është foto dora, të cilën e ka futur në pjesën intime. Kjo është një mënyrë provokative e këngëtares për t'u paraqitur në rrjetet sociale dhe pse jo për të tërhequr më tepër vëmendjen. Kjo foto është hedhur në 'Instastory' së bashku me shumë foto të tjera. Ndërkohë që këngëtarja e cila po vazhdon karrierën muzikore jashtë vendit, është duke punuar për këngën e re dhe do të jetë pjesëmarrëse në festivalin 'Synny Hill' të cilin e ka organizuar Dukagjin Lipa, babai i Dua Lipës. Aty Dafinë pritet të performojë në të njëjtën skenë me ish-të dashurin e saj, Ledri Vula.



SA I VOGËL DHE NOTON VETË! ANSI I SINAN HOXHËS NA HABIT TË GJITHËVE

Ai është një ndër ba ballarët më të devotshëm ndaj vogëlushit të tij. Këngëtarja Sinan Hoxha është mjaft i dhënë pas djalit të tij, Ansi dhe shpesh poston foto apo video të tij. Këtë herë ai ka publikuar në 'Instagram' një foto ku shohim vogëlushin që lahet në det ku në krahë i janë vendosur "krahëzat-komerdare" të cilat ta ndihmojnë të notojë vetë. Me siguri që këtë vit vogëlushi Ansi do të mësojë shumë shpejt që të notojë edhe pa ato, si një notar i vërtetë!



Ç'NDODHI ME KËNGËTAREN? POSTON FOTO E SHTRIRË NË SPITAL

Ajo është padyshim një ndër emrat më të lakuar në mediat rozë, edhe pse është shkëputur pothuajse për një kohë të gjatë nga rrjetet sociale. Donjeta Kosumi, e njohur ndryshe si "Kallashi", vendosi që vetëm para disa ditësh të rikthehet në rrjetet sociale. Por ajo që ka tërhequr vëmendjen ishte se këngëtarja në postimin e fundit në 'Instastory', ka publikuar një foto nga spitali. E shtrirë në krevat, ajo ka fotografuar dorën e saj ku duket se është duke marrë një infuzion. Ç'të ketë ndodhur me Kallashin?



BOULEVARDI

POLITIK

Në merrni seriozisht!

Aleksandër Meksi 79 vjeç. Ish-kryeministri, krah dy nipave

Aleksandër Meksi sot është 79-vjeç, por vitet nuk i ndjen fare. Ish-kryeministri i vendit dje u shfaq më në formë se asnjëherë, krah dy nipave të tij, ndërsa foton e ka postuar në llogarinë e tij në 'Facebook'. Prej kohësh, Meksi ka preferuar të qëndrojë larg jetës politike shqiptare. Aleksandër Meksi ka qenë kryeministër i Shqipërisë nga viti 1992 deri në vitin 1997, është kryeministri i parë i pas rrëzimit të sistemit komunist dhe një ndër themeluesit kryesor të PD-së.



Seehofer, për Merkelin: Me këtë grua s'mund të punoj!

Qeveria gjermane është sot para sfidash të mëdha, që kërcënojnë seriozisht koalicionin e arritur me shumë mundim. Kancelarja Angela Merkel këmbëngul që çështja e refugjatëve të zgjidhet në marrëveshje me vendet e tjera, ndërsa ministri i Brendshëm, Horst Seehofer, i shndërruar tashmë në kundërshtarin e saj më të madh, ka të tjera plane e thotë se "me këtë grua nuk mund të punoj". Çështja e emigrantëve është aktualisht temë kryesore në Berlin e Bruksel. Seehofer kërkon të mbyllë kufijtë për refugjatët, por, nëse kjo ndodh, thekson "Deutsche Welle", - vendet e Ballkanit mund të kenë probleme serioze me azilkërkuuesit, shumica e të cilëve kalojnë pikërisht këtej.



Ish-deputeti, dedikim gruas: Gjithë ditën mendova për dhuratën

Ish-deputeti i LSI-së, Flamur Çelaj ka festuar ditëlindjen e bashkëshortes së tij Belinda. E, në fakt, deputeti ka zgjedhur fjalët më të bukura për ta uruar publikisht. Në llogarinë e tij në 'Facebook', ai ka postuar një foto duke u puthur me gruan e tij, dhe krah saj shkruan: "Gjithë ditën mendova për dhuratën, por në mbremje kuptova që për ty, e dashur, prezenca ime është më e rëndësishme se të gjitha dhuratat. Të uroj edhe 100 pranvera dhe gëzofshim së bashku me fëmijët dhe të afërmit tanë çdo ditë që na fal i madhi Zot".



Për Vuçiç, Kupa e Botës është më e rëndësishme se Kosova

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç kishte planifikuar t'i drejtohej më 16 qershor opinionit përmes Radio Televizionit Shtetëror Serb, për të bërë publike ofertën e marrë nga Perëndimi për Kosovën, por sipas të përditshmes beogradase "Danas", ai vendosi ta shtyjë këtë datë dhe arsyeja është pikërisht Kupa e Botës. "Danas" shprehet se Vuçiç nuk ka hequr dorë nga planet e tij për ta diskutuar çështjen sa më shpejt, por kampionati botëror i futbollit mund ta detyrojë që ta lërë njoftimin për një datë më të vonë.

Dosjet e viteve 1993-2008, formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë e vendimeve

Ornela Manjani

Pronarët në Korçë, ATP merr në shqyrtim 10 mijë dosje

Problematikat, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit

Agjencia e Trajtimit të Pronave Publikon listën me 10 mijë dosje ish-pronarësh, që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkuessit janë në qarkun e Korçës. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit, gjeneralitetet e kërkuessit, sipërfaqet e njohura për kompensim, dosjet për pronarët që kanë marrë vendim negativ dhe dosjet që duhet të plotësohen. Dosjet janë të viteve 1993 deri në vitin 2008. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vënë në dispozicionin të pronarëve formularin-tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në 'Agjencë' për t'u njohur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia Trajtimit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

FORMULARI

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tri seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjen-

eralitetet, adresën dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përshkruar në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkon informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuar pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

APLIKIMI

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes, subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së kërkesën përkatëse me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie

DOKUMENTACIONI QË DUHET TE PARAQISNI

- Formulari-tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish-KKP/AKKP (nëse ka)
- Dokumente të tjera

dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në 'Agjencë'. Më pas, kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon, ia dërgon të gjitha kërkesat e ardhura drejtorit të përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sek-

torit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas, sektori përkatës përgatit informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën e kthimit të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë, sipas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.

The image shows a detailed application form titled 'FORMULARI APLIKIMI' for the Agency for the Management of Public Property. It includes sections for personal information, address, and identification documents. There are checkboxes for marital status and gender, and fields for phone numbers and email addresses. The form is in Albanian and includes a QR code in the top right corner.

KORÇË

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuess)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuess)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
310	KOLONJE	JANAQ		DANO		
291	POGRADEC	PETRAQ		THOMAJ		
293	KOLONJE	EQEREM		MALLUKA	MOSMIRATIM KERKESE	
294	POGRADEC	MITI		ANDONI	MOSMIRATIM KERKESE	
297	POGRADEC	HASAN		LATIF	MOSMIRATIM KERKESE	
295	KOLONJE	ALIE		KOCU	MOSMIRATIM KERKESE	
313	KOLONJE	VANGJEL		DHONO	MOSMIRATIM KERKESE	
312	KOLONJE	ROLAND		QIRAJZI	MOSMIRATIM KERKESE	
324	KOLONJE	BILO		MURATAS	97967 M2	
317	KOLONJE	FATBARDDHA		SHKUPI	MOSMIRATIM KERKESE	
299	KOLONJE	MERJEME		VEIZI	1760 M2+3760 M2	
	KOLONJE	MERJEME		VEIZI	19740 M2	
298	KOLONJE				MOSMIRATIM KERKESE	
	KOLONJE	MARIGO		STEFO	44394.5 M2	
296	KOLONJE	ARIAN		DEMCE	MOSMIRATIM KERKESE	
309	KOLONJE	VOISAVA		SHKURTI	MOSMIRATIM KERKESE	
308	KOLONJE	SALI	RIZA	BUJARI	MOSMIRATIM KERKESE	
304	KOLONJE	FASLU		VLLAMASI	MOSMIRATIM KERKESE	
306	KOLONJE	ASLAN		BEGO	36100 M2	
303	KOLONJE	SOTIRIAQ		ZOGRAFI	MOSMIRATIM KERKESE	
302	KOLONJE	THIMI		ITE	MOSMIRATIM KERKESE	
301	KOLONJE	URAN		KOSTRECI	MOSMIRATIM KERKESE	
316	KOLONJE	EDUART		SHUAIPI	MOSMIRATIM KERKESE	
314	KOLONJE	VANGJEL		DHAMO	MOSMIRATIM KERKESE	
311	KOLONJE	STEFAN		PRIFTI	MOSMIRATIM KERKESE	
320	KOLONJE	KAPLLAN		GRAMO	MOSMIRATIM KERKESE	
69	DEVOLL	TRASHEGIMTARE TË TËJ			22 DY	
66	DEVOLL	SULEJMAN		GALO		NRE DOSJE NDOODHET FOTOKOPIJE E VKKPK NR.92, DT.13.06.1995
60	DEVOLL	XHEMAU		COLLAKU		
72	DEVOLL	KOMISIONI I KESHILLIT TE XHAMISE KAPSHITICE		KOMISIONI I KESHILLIT TE XHAMISE KAPSHITICE	10000 M2	
65	DEVOLL	SNAI		MULLA	3785 M2+4805 M2+1280 M2	
67	DEVOLL	REMEZ		NALLBATI		
68	DEVOLL					
71	DEVOLL	IRFAN		BEGOLLI		
64	DEVOLL	ZIJA		CANE		
63	DEVOLL	MYNEFE		LAPI		
62	DEVOLL	GURJUE		KALANI		
61	DEVOLL	BESIM		UZHURI		
224	KOLONJE	ISMAIL		VASHA	11300 M2	
15	KOLONJE	HEKURAN		LAHO	3742 M2+4474 M2 DHE SIPAS NENIT 3 S.6553 M2	
390	KOLONJE				SHTEPI 251 M2 DHE TRUALLI 459 M2	
188	KOLONJE				1248 M2 DHE SIPAS NENIT 3 S.8148 M2	
241	KOLONJE	PETRIT		OSMANAJ	360 M2+504 M2 TE MOS SHQYRTOJE 1571 M2	
90	KOLONJE	SEFER		EMIN	509 M2+1060 M2	
300	KOLONJE	PERPARIM		ISAI	720 M2+2040 M2	
9	KOLONJE				1648 M2	
36	KOLONJE	ALIE, JUSUF		BYREKASI	675 M2 NUK TRAJTOHET S+212 M2	

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuess)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuess)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
144	KOLONJE	DHIMITER		XHEKA	375 M2	
105	KOLONJE	VANGJEL		THOMA	430 M2+208 M2+187 M2+464 M2+270 M2+56 M2	
334	KOLONJE	ADRIATIK		NAZARKO	494 M2+489 M2+576 M2+1260 M2	
331	KOLONJE	MYFTAR		NAZARKO	2944 M2+2200 M2	
83	KOLONJE				2650 M2 TE MOS SHQYRTOHET 1242 M2	
355	KOLONJE	GIJERGJII		CAKULI	308 M2 NUK SHQYRTOHET 1323 M2 DHE NUK I NJIHTET 440 M2	
	KOLONJE	GIJERGJII		CAKULI	1323 M2	
123	KOLONJE				432 M2 DHE 288 M2	
189	KOLONJE	ILIA		DOSTI	265 M2	
69	KOLONJE	ALIE, NEVRUZ		META	1405 M2	
93	KOLONJE	FILIP		THOMOLLARI	336 M2+271 M2	
73	KOLONJE	KICO		PRIFTI	922 M2	
318	KOLONJE	SIMINA		QIRICI	300 M2+156 M2	
183	KOLONJE	ILIA		ZOTO	770 M2	
251	KOLONJE	ALI		PODA	1156 M2 NUK TRAJTOHET 2205 M2	
45	KORCE	LLAZI		SILU	6000 M2	
	KORCE	LLAZI		SILU	MOSPRANIM KERKESE	
48	POGRADEC	PETRIT	KRISTAQ	KOLE	23333 M2+2270 M2	
49	KORCE	VASIL		BALLAURI	40000 M2	
	KORCE	DHIMITRAQ		BALLAURI	54000 M2	
50	KORCE	MYNEVER		LUFU (HADRI)	3000 M2	
216	KORCE	SUP		LIMONAS	46300 M2	
218	KORCE	BESHK	SELIM	BACE		
150	KORCE	PELLUMBESHA		GOREZI (CENE)	12000 M2 MOSNJOHJE TE S+3000M2	
130	KORCE	IKBALE		GOSKOVA	6000 M2	
	KORCE	IKBALE		GOSKOVA	3000 M2 MOSNJOHJE TE S+2000 M2	
191	KORCE	ALFRED		MELO	160 HA	
	KORCE	NEFIZE	MEHMET	SALIHANU	605 HA MOSNJOHJE 54 HA	
180	POGRADEC	BASHKIM JASHARI BEKIM		GUXHOLLI	8000 M2	
15	KORCE	ZHANETA		NOSI	528 M2	
16	KORCE	ZHANETA		NOSI	57817 M2	
	KORCE	ZHANETA		NOSI	3602 M2	
16	KORCE	ZHANETA		NOSI	4200 M2 MOSKTHIM TE 4200 M2	
12	KORCE	ILIE		NAJINI(MEHMETI)	848 M2	
11	POGRADEC	NEXHMIJE	HARIZ	LATKA	11118 M2	
56	DEVOLL	NUAJI		BYLYKBASHI	16570 M2	
317	KORCE	NEIM	ALIQEMAL	TUXHARI		
	KORCE	NEIM	ALIQEMAL	TUXHARI	13900 M2	
196	KORCE	NEIM	ALIQEMAL	TUXHARI	10578 M2	
28	KORCE	LURJAN	RHEJAL	ROSHANU	33000 M2	
38	POGRADEC	BAROHYL	RAUF	MAJELLARI	2800 M2	
29	DEVOLL	MELEQ		MULLA	SHPETIA	
	DEVOLL	MELEQ		MULLA	3000 M2	
23	POGRADEC	FREDI		MUCI	9227 M2	
	POGRADEC	FREDI		MUCI	SHFUGJIZIM I V. 126	
	POGRADEC	FREDI		MUCI	9227 M2 MOSNJOHJE 7976 M2	
17	KORCE	PANDELI		FACE	6500 M2	
	KORCE	KRISTAQ	UGOR	KAFEXHI	5200 M2 NDORSHIM I PIKES 1/CTE V. 305	
194	KORCE	EMIL		MBORJA	31600 M2	
222	KORCE	SKENDER		VRENZOZI	360 HA	
223	POGRADEC	QEFSERE		BERBERI	1750 M2	

(vijen)

Opinioni / Ditës

A mund të jemi tifozë me Serbinë, sepse ndiqnim TV jugosllav?

Nga Armand Plaka

Ndoshta do të duhej të hapej me kohë e si shkak shërbeu pikërisht Botërori i Futbollit, pasi s'kishte si ndodhte ndryshe. Një debat që fokusoji debatet teknike e mediatiche për ecurinë e "Russia 2018", zuri për pak caste ditët e fundit rreshtat e gazetave, portaleve e paddyshim, mediave sociale.

Komentatori i mirënjohur Kosta Grillo, i cili këtë radhë duket se ka preferuar të rrijë larg profesionit të tij primar (pasi siç pohon edhe vetë ka kohë që merret me menaxhimin e futbollistëve), komentimit të ndeshjeve në TVSH, ka shkaktuar termet të vërtetë me deklaratën e tij për mbështetjen publike që do i bënte Ekspit Kombehtar të Serbisë në këtë Botëror, duke e arsyetuar pak a shumë me faktin se në mungesë të Shqipërisë, apo Hollandës, ekipeve të tij të zëmërs, ka preferuar t'na ndëshirë për ngadhënjim në eventin më madhor futbollistik me Kombëtares serbe.

Në televizionin "Ora News", ai ka deklaruar: "Jam tifoz i Serbisë, normalisht edhe me Hollandën, por mungon Holanda dhe jam një tifoz i Serbisë, pasi është edhe nga Ballkani, jemi të lidhur me futbollin serb, unë kam tifoz i Zvezdës që kur kam qenë fëmijë", tha Kosta Grillo.

Të lindroshtë përtej hipokrizisë Deri këtu besoj se ka pasur të drejtë e duke thyer një tabu, ka lundruar përtej hipokrizisë. Kështu duket në pamje të parë, por nëse i hyn më thellë, duket se ai çdon jo pak kur merr përsipër të flasë në emër të një kontingjenti të madh shqiptarësh, të cilët në shtrirje gjeografike dhe kohore përbëjnë ndoshta edhe palcën kurriore të popullsisë së sotme jo pak aktive në vend.

Pohon se ka marrë qindra mesazhe e mbështetje për deklaratën e bërë nga bashkëmoshatarë, miq, kolegë, të njohur e të panjohur. Edhe kjo s'ka asgjë për t'u kritikuar e nuk kemi pse të mos i besojmë.

Nga ana tjetër po nga mediat zyrtare e rrjetet sociale mësojmë për qindra reagime, të cilat variojnë që nga sharjet banale, deri në thirrjet për bojkot, "përjashtim nga puna" e gjoha ndaj tij e drejtuesve të TVSH, e cila theksohet se mbahet nga taksat e shqiptarëve.

Por, le ta zgjerojmë pakëz diskutimin, i cili dukshëm dhe pashmangshmërisht i kalon tashtëm kufijtë e sportit për t'u ndërthurur me politikën, historinë e më gjerë, pavarësisht se duhet thënë se Grillo në reagimet e mëpasshme këmbëngul ta mbajë këmbën vetëm në sport e të mos e përziejë në të politikën.

TV ish-jugosllav, monopol i studios së Beogradit

Fakti që televizionin ish-jugosllav, në atë kohë (vitet '70 dhe '80) i alternuar, ku siç merret me mend stafeta kryesojë nga Beogradit për të kaluar më pas në studiot e tjera si Zagreb, Sarajeva, Podgorica, Shkupi e deri te Ljubjana (ku studios së Prishtinës rrallëherë i vinte radha të shfaqje), shihej gjerësisht në territore të mëdha të Shqipërisë në monotone, para së gjithash në veri, në Ulëtisërë Perëndimore e në Shqipëri të



Mesme, nuk përbën një argument përcaktues për të besuar se Serbia paskësh pasur kaq shumë tifozë "të fshehtë" në këtë vend.

Argument nuk përbën as fakti se shqiptarët ndiqnin falë TV, edhe filma, koncerte e njihnin grupe të rock-ut ish-jugosllav, e as këngëtarë të folkut, apo etnomuzikës sllave, e po ashtu as edhe fakti se po ashtu njihnin mirë edhe një sërë ekipesh, lojtarësh, e madje edhe komentatorësh sportivë, të cilëve ua dëgjonin zërin ku nën zë e ku fare hapur, duke diskutuar për ta ku mundnin e si mundnin, ndërsa s'fidonin në një farë mënyre edhe vetë sistemin, që duket se kishte kohë që kish nisur ta toleronte diçka të tillë.

RAI dhe TV ish-jugosllav, kë ndiqnin më shumë shqiptarët?

Duket pohuar se shqiptarët ndërkaq kishin "luksin" të ndiqnin përnatë edhe TV italiane, duke u ndjerë më të afërt me atë kulturë, pasi në shumicë i kuptojnë edhe gjuhën. Në këtë mënyrë, TV ish-jugosllav sikurse edhe RAI e një grusht kanalesh private italiane përbënte për ta një alternativë sigurisht për t'u larguar monotonisë që ofronte RTSH, por me veçantitë që kishte, merret me mend se ndjekja e TV jugosllave përtejohet ndryshe, edhe pse në raport më të vogël në krahasim me ato italiane.

Ndjekja e tij ishte më e kritikuar, më e anatemuar, sikurse standardet e tij ishin më të dobëta, programet e tij më të vrazhda e gjuha e tij më e pakuptueshme se ajo e TV italiane. Ndërkaq, ky fenomen nuk ishte vetëm shqiptar, pasi TV ish-jugosllav shihej gjerësisht edhe në vendet e tjera kufitare me ish-jugosllavinë, federatën rebele që shihej me të drejtë si një farë lidhëse mes Lindjes e Perëndimit e që ishte shpesh model për bullgarin e rumunin e thjeshtë, sikurse për shqiptarin e madje edhe për hungarezin.

Por kush më shumë e kush me pak e dinim se të tjerë idhuje e kombe kishin në kokë kur flisnin për futboll, nga ata që gjendeshin përtej këtyre kufijve, e që ishin vërtetë ëndrra e çdo shqiptari të kohës.

"Lugina e shurdhëve" dhe raste e ngjashme në ish-Lindje Në vitin 2004, ndërsa merrja

pjesë në një seminar për digjitalizimin në Lajpcig të Gjermanisë, pranë TV MDR, pjesë e TV-së të ish-RDGJ-së, tashtë më transformuar tërësisht, paneli i diskutantëve më pyeti se si ia bënin në të Shqipëri në atë kohë të izolimit total në këtë aspekt?

Iu përgjigja se paradokset ishin prezente edhe në atë sistem e se jo çdo gjë duhej parë bardhezi. Edhe pse të izoluar, kultura botërore perëndimore e madje edhe ajo e kombinuar, kalonte tek ne sidomos në vitet '80 përmes TV italiane e jugosllave përnatë në shtëpitë tona. U hodhën menjëherë kolegë nga ish-Lindja, duke sjellë raste se si polakët për shembull, ndiqnin TV çekoslovak, se si bullgarët ndiqnin TV jugosllav, se si rumunët përveç atij jugosllav përpigjeshin të ndiqnin atë sovjetik etj.

Më emblematike ishin rastet që lidheshin me përpjekjet e gjermano-lindorëve për të ndjekur valët e TV-ve gjermano-perëndimore. Madje, më ka mbetur në mend rasti sarkastik i zonave në të cilat nuk arrihej të kapej sinjali i TV-ve të RFGJ-së, e që në zhangonin popullor të ish-gjermano-lindorëve njiheshin si "Lugina e shurdhëve" (ose e atyre që s'ia kanë fare haberin, origj. gjermanisht: Tal der Ahnungslosen).

Ndikim jo deri në ekstremitet për t'u rikthyer edhe një herë diskutimit bazë, mund të pohoj se edhe vetë, megjithëse i takoj një brezi që ka arritur të kapë vetëm fundin e atij sistemi, e ndiqja TV ish-jugosllav, e edhe pse kohë e largët, më kujtohen fare mirë sidomos komentot plot patos të komentatorëve sportivë jugosllavë, por edhe plot grupe e këngëtarë. Mund të them se kam aq mënjë farë nostalgji për një kohë kur diçka që e shihej sonte, diskutohet nesër nga të gjithë, sepse s'kishte alternativa e as internet. Së bashku me TV italian ish-in paddyshim një zgjidhje oportune për të krijuar një kontakt me botën. Por kisha vënë re se jo të gjithë e ndiqnin. Kisha madje edhe preferencat e mia për ekipet sllave të futbollit, por edhe të basketbollit, por e vërteta është se kurrë s'më kishte shkuar ndërmend të brohorisja për Serbinë, sepse s'e ndjeva kurrë diçka të tillë në

thellësi të zemrës. Edhe pse pa mundësi për t'i parë nga afër, e dija se Gjermania, Anglia, Italia, Franca apo SHBA, përtej futbollit ishin ëndrra jonë.

Kështu që më duket i tepruar dhe i pabazuar pretendimi i Kosta Grillos se në Shqipëri paskësh shumë tifozë të Serbisë. Fakti se kanë mundur të ndjekin në një kohë apo stacion të jetës së tyre, i cili realisht lë gjurmë në gjithë jetën e tyre, TV ish-jugosllav nuk do të thotë automatikisht se duhej të ishte e të jesh për më tepër sot, tifoz i Serbisë.

Për kë bënin tifo kosovarët?

Por si qëndronte puna me vëllezërit tanë shqiptarë që jetonin në Kosovë e ish-Jugosllavi? Duhet pohuar se në kushtet që jetonin e alternativat që u ofroheshin nën okupim, nëse kishin rast, maksimumi preferonin ta deklaronin veten si jugosllavë dhe jo si serbë, e paradoksalisht, edhe pse nuk kishin mundësinë të duartrokisnin për Kosovën për shembull, fakti se jetonin në një federatë, u ofronte mundësinë që të paktën të gjenin ngushëllim tek Jugosllavia e jo tek Serbia, duke preferuar një lloj "shitje" apo "shkriarje" të identitetit të vet nacional, por pa preferuar në asnjë çast të nxirrin në pah atë serb, ndërsa as që diskutohet se thellë në zemër e në shpirt ata ishin ndjekës e tifozë të zjarrtë të Shqipërisë.

Fakti se shumë syresh duhej të punonin në profesione të ndryshme duke bashkëpunuar edhe me serbët, nuk i bën ata aspak fajtorë (përveç atyre që me zell ndihmuan mbajtjen më këmbë të okupimit e më ndërgjegje ushqyen pushtetin sllav në Kosovë duke ekzekutuar, burgosur e torturuar vëllezërit e tyre të gjakut). Të tillë gjeje në art, sport, por edhe në shumë fusha të tjera, sepse pa pasur kyçje në sistem, ishte e pamendueshme se mund të bëje diçka e të mbijetoje në ato kushte.

Kjo, por edhe dialektika e zhvillimit, shpjegon edhe prezencën e legendës së ndjerë (të saponarë në mënyrë të parakohshme nga kjo jetë), Fadil Vokrri për disa vite në radhët e Partizanit të Beogradit, por edhe sukseset të tjera, të cilat paddyshim që përbëjnë arrijet individuale tepër të çmuara të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, e si të

tilla duhen ndëruar gjithmonë. Suksesi i të ndjerit Vokrri në çuarjen përpara të objektivave madhore të Federatës së Futbollit të Kosovës, por edhe respekti që treguan drejtuesit e Partizanit të Beogradit për t'a përkujtuar atë dhe kontributet që ai dha për atë klub, e vërtetojnë edhe më shumë këtë tezë.

Nga ana tjetër na duhet të llogarisim edhe një pjesë vërtetë të emancipuar të ish-shtetit jugosllav e atij serb, e cila ka kontribuar që të mbahen në këmbë disa lidhje sa njerëzore aq edhe të domosdoshme mes dy popujve, të cilët historikisht e kanë parë njëri-tjetrin me mosbesim.

Futbollistët serbë, të vetmit që mbrojtën ata shqiptarë

E në këtë kontekst, shtrohet pyetja: a kishim ne ç'të mësonim nga ish-Jugosllavia në përgjithësi? Nga arti, sporti, kultura e saj? - Pa drojë e dyshim sigurisht se duhet të themi 'Po!' Pa drojë e mëdyshje mund të themi se shqiptarët si mendjepuar e përthithës kulturash, kanë përfituar nga kjo aty ku kanë mundur, se e kundërta tek serbët nuk ka ndodhur, e unë besoj se ata kanë humbur diçka në këtë mes.

Duke lënë pas historinë e hershme e politikën, të afrohemi në kohë e të shohim nën dritën e zhvillimeve të fundit? A mundet të pohosh aq lehtësisht se je tifoz me Serbinë pas atyre që ndodhën vetëm katër vite më parë e kur e ke parë me sytë e tu dheunë e çmendurinë e pamotivuar të një turme frenetike ndaj një formacioni sportiv, që u la tërësisht i pambrojtur në mes të Beogradit, duke thyer kështoj jo vetëm rregullat bazale të UEFA-s, por edhe ato më minimale të mbrojtjes të mysafirëve sipas një tradite të gjithëpranuar ndërkombëtare?

Sigurisht se në të gjithë këtë mesele, paradoksalisht dhe fatmirësisht ata pak shembuj që erdhën në mbrojtje të lojtarëve tanë në atë zallamha të bashqoë beogradase, ishin pikërisht nga vetë lojtarët e Kombëtares serbe, nga kolegët e tyre, të cilët nuk ngurruan të ngrinin duart e t'i mbironin e më pas të shprehnin publikisht edhe keqardhjen, pavarësisht "Provokacija"-s që nxitu fluturimi i dromit mbi kokat e nxehta të sivëllezërve të tyre, duke dhënë një shembull pra se sporti qenka shumë më lart se politika e turmat frenetike ultranacionaliste.

Nga ana tjetër, duke pasur parasysh se të qenurit tifoz i një ekipi apo ndjekës i një klubi futbollit është para së gjithash edhe një akt mirëbesimi, një afekcion që shkon përtej rezultateve thjesht sportive, e bën pohim të Grillos për Crvena Zvezdën, disa anakronik e për shumë syresh provokues, duke pasur parasysh se çfarë përfaqëson ajo për shqiptarët.

Sidoqoftë, duke mos preferuar të bëj as avokatit e as kritikun e Kosta Grillos, mendoj se pohimet e tij përkojnë me ato që theksava në hyrje të këtij reagimi, duke i parë më shumë si një vlerë të shtuar, sepse bënë të mundur të flitet për një temë, e cila shumëkënd mund ta bënte të skuqje, e në këtë kontekst, si njeri profesionist që lundron pa frikë e drojë përtej hipokrizisë, akti i tij është për t'u përkëndetur.

Opinion

i Ditës

“Divorc” me simotrën bavareze apo fundi politik i Merkel?

Dr. Jorgji KOTE

(villon nga faqja 1)

... gjuhëzuan Meksikës, dje, vëmendja politike dhe publike u spostua në Berlin dhe Mynih, ku zhvillohej dueli “për jetë a vdekje politike” ndërmjet Kancelares Merkel, lidere e CDU-së dhe Horst Seehofer, shefi i “simotrës” historike të CSU-së të Bavarisë. Por kaosi institucional para “portave” të këtyre dy partive është shumë më i ngatërruar se lëmshi futbollistik german. Vetëm tre muaj nga krijimi plot mundime, koalicioni i madh gjerman është përfshirë nga debate dhe grindje të ashpura. Ato u tensionuan skajshëm pas propozimit të Seehofer tashmë dhe si ministër i ri i Brendshëm për zbatimin menjëherë të Master Planit me 64 pika mbi Emigracionin ndonëse “mollë shërri” janë vetëm dy pika që kanë të bëjnë me kthimin e azilantëve në vendet e BE-së ku janë regjistruar më parë.

Gjatë dy javëve të fundit, Kancelarja Merkel dhe ekspozentët më të lartë të CDU-së kanë bërë çmos për të bindur aleatin e vet historik që të hequr dorë nga zbatimi i këtij plani, sepse nuk shkon që vendi themelues dhe më i madh i BE-së të ndjekë politika të njëanshme e të përenduara me partnerët e tjerë. Sidomos nga CDU/CSU që e kanë evropianizmin në AND-në e tyre politike. Edhe pse kjo krizë ka tre vjet që sorollatet kancelarive të BE-së pa gjetur ende zgjidhje, cka u jep “munition” forcave ekstremiste dhe populiste e në këtë rast dhe vetë CSU-së. Merkel ka propozuar kompromiset e rastit, në radhë të parë shtrimin e kësaj çështjeje në Samitin e BE-së në fund të këtij muaji, kur do të shqyrtohet strategjia e re migratore. Madje ajo ka filluar qysh dje takimet me homologët e saj francezë, italianë, austriakë.

Me gjithë këto demarshe dhe lëshime ndaj CSU-së, këta të fundit kanë deklaruar se “nuk do të tërhiqen asnjë milimetër” nga pozicionet e tyre. Për pasojë, rrezikohet seriozisht divorci politik i këtyre dy partive, edhe pse CSU ka deklaruar se nuk e synon një gjë të tillë. Mirëpo qëndrimet e saj dhe fillimi i zbatimit të Master Planit pa miratimin e Kancelares do të çonte detyrimisht në shkarkimin e Seehofer, largimin e CSU-së nga koalicioni dhe rënien e qeverisë federale, ndoshta dhe të Merkel dhe zhvillimin e zgjedhjeve të reja të parakohshme; kjo e fundit do të ishte gjëja më e padëshiruar për Gjermaninë dhe Europën dhe dhu-rata më e mirë për forcat euroskeptike dhe ekstremiste.

Megjithëse ky konflikt që tashmë vjen “nga brenda” e ka dobësuar atë si asnjëherë tjetër politik-



isht, Merkel nuk ka gjasa të japë dorëheqjen edhe në rast të largimit të CSU-së nga koalicioni. Vetëm se asaj i duhet të shmangë zgjedhjet e reja të parakohshme dhe për pasojë fundin e saj politik, duke gjetur aleatë të ri në Bundestag. Liberalët janë kundër një koalicioni të tillë, e ca më pak me Merkel, ndaj mbetet vetëm të Gjellbërit me 67 vende në parlament për të kompensuar 46 votat e CSU-së. Diçka jo e lehtë dhe me pikëpyetje, pasi ata dallojnë shumë nga CDU dhe SPD edhe në politikën liberale migratore; por ndërmjet dy të këqijave, Merkel do të zgjedhë të keqen më të vogëlën. Ndërsa social-demokratët partnerë në këtë koalicion e mbështesin Merkel; ata nuk kanë interes për zgjedhje të parakohshme, pasi nuk kanë shans për fitore, veç faktit që këto zgjedhje mund “të çonin ujë në mullirin e forcave ekstremiste e sidomos të Alternativës për Gjermaninë.

Ndërkohë, llogaritë politike të liderëve të CSU-së nga dalja e saj nga koalicioni në përpjekje për largimin e Merkel, mund të rezultojnë më të dëmshme për vetë CDU-në dhe lidërshtimin e saj. Kjo mund të fillojë qysh me zgjedhjet e reja bashkiake në tetor, sepse, pavarësisht peshës elektorale të

CSU-së, e cila ka 70 vjet që “bën ligjin” në Bavari, kjo dhe falë një pjese të madhe që mbështesin CDU-së dhe e Merkel, këta mund ta “tradhtojnë” CSU-në, të krijojnë filialin e CDU-së në Bavari dhe kështu t’i japin fund “sundimit” demokratik të CSU-së; veç forcimit të mundshëm të SPD-së dhe të Gjellbëve, duke e gërryer seriozisht më tej CSU-në.

Nisur nga këto probleme dhe specifika delikate, dje, Merkel nga Berlini dhe Seehofer nga Mynihu ku ishin mbledhur me shtabet e tyre partiake vendosën një “armëpushim” dyjavor; cka do të thotë që nuk do të fillojë zbatimi i Master Planit pa miratimin e Merkel deri në përfundimin e Samitit të BE-së. Por, gjasat janë që dhe ky Samit të mos arrijë gjë. Qysh tani, Viktor Orban, ka propozuar që Strategjinë e re evropiane për azilin ta shqyrtojë pas zgjedhjeve evropiane 2019. Nëse Samiti dështon, atëherë Merkel për të dalë nga ky qerthull i rrezikshëm krize mund të detyrohet “të ndezë dritën jeshile” për zbatimin e Master Planit të CSU-së; por kjo jo në mënyrë automatike, siç kërkon CSU-ja, por në konsultime të nëntejshme ndërmjet dy partive dhe me partnerët evropianë. Me siguri që Merkel do ta shfrytë-

zojë këtë afat dy javor për të marrë masa për rastin më të keq, që “ndeshja” pas kësaj shtyrjeje të përfundojë ndoshta me divorc, por jo me fundin e saj politik; ky do të ishte ogur i keq për forcat proevropiane.

Këto zhvillime tejet negative janë unikale në historinë mbi 50-vjeçare të bashkëpunimit të ngushtë të këtyre dy partive. Veç një rasti disi më të lehtë 40 vjet më parë CDU/CSU me liderët e tyre emblematikë e futën Gjermaninë në BE, NATO, ata udhëhoqën procesin e ribashkimit gjerman dhe atij evropian, etj; ato kanë qenë përherë bashkë, madje dhe me kandidatë unikë për kancelarë; dy prej tyre kanë qenë nga CSU-ja, emblematiku dhe miku i madh i vendit tonë, Straus më 1980 dhe karizmatiku Stoiber në vitin 2002. Ndaj dhe koalicioni CDU/CSU njihet ndryshe si “Union”.

Pyetjes: “Pse tani, me aq urgjencë dhe ultimative CSU-ja ndaj simotrës së saj më të madhe?”, shumica e ekspertëve dhe analistëve i përgjigjen me synimin e saj madhor për të joshur masat e gjera në prag të zgjedhjeve bashkiake në tetor. Ata janë të frustruar, sepse në zgjedhjet e kaluara AfD-ja u rrëmbou atyre një pjesë të madhe të elektoratit tradi-

cional kryesisht për shkak të mosvendosmërisë në politikën migratore. Ndaj, për CSU zgjedhjet bashkiake në tetor konsiderohen si “nëna e të gjitha zgjedhjeve” dhe “o tani, o kurrë”.

Mirëpo vetëm kjo arsye do të ishte gjysma e së keqes. Në fakt, përplasjet dhe përçarjet e tanishme nuk lindën nga hiçi apo brenda një nate; as sepse Bavaria është privuar nga ndonjë e drejtë, sepse ajo ka qenë në bashkëqeverisjen federale; apo se ka pasur probleme me papunësinë apo varfërinë si në rastin e Italisë. Kjo ka ndodhur CSU po anon drejt prirjeve populiste të djathta në landin më të pasur gjerman me 12 milion banorë. Kështu, Horst Seehofer konsiderohet si “babai shpirtëror” i Viktor Orbanit. Ai ka qenë përherë në favor të mbylljes së njëanshme dhe hermetike të portave për azilërkuesit më 2015 dhe “kufijtë të sipërm” (Obergrenzen). Kurse kryeministri bavarez, Markus Soder ditët e fundit ka paralajmëruar fundin e multilateralizmit, etj.

Madje, dhe kur mendohej se këto dallime ishin sheshuar me krijimin e koalicionit të ri qeveritar tre muaj më parë, Seehofer sapo hyri në zyrën e tij si ministër i ri i Brendshëm Federal “nxeheu gjakrat” në politikën gjermane me deklarinimin e parë publik se “Islami nuk i përket Gjermanisë”; pak më vonë, qeveria bavareze vendosi që në çdo institucion qeveritar të vendoset kryqi si simbol i identitetit të këtij landi që shkaktoi shumë polemika. Me politikën që po ndjek, për CSU ndonëse me rrënjë të thella evropianiste, “e para është Bavaria, Jo Europa madje as Gjermania”.

Si populistët në përgjithësi, dhe CSU po shquhet për theshtëzimin ekstrem të dukurive tejet komplekse si azili; bërtasin për dështimet, por nuk duan t’ia dinë për arrijet, që shifrat e azilërkuesve vitin e kaluar në BE pësuan rënie të ndjeshme me 44 për qind kurse në Gjermani 70 për qind! Për ta pak rëndësi ka që dhe në rast se Gjermania tenton të kthejë azilërkues, nuk ka kurrfarë sigurie se ata do të pranojnë nga vendet si Italia, Greqia, Austria, etj., pa marrëveshjet përkatese dypalëshe. Të mos hyjmë pastaj të mungesa e humanizmit për azilantët fëmijë, të mosuar, të sëmurë, gra shtatzëna.

Gjithësesi, pavarësisht nga mbështetja që gëzon CSU në qëndrimet e deritanishme, ekziston shpresa se shumica dërrmuese e popullsisë bavareze, këtij landi proevropian, përëndimor e kozmopolit, kjo “urë miqësie e bashkëpunimi dhe e Ballkanin e Shqipërinë, nuk do të pranojë që në Mynih të ngrihet flamuri i populizmit dhe euroskepticitimit.

Opinioni *i* Ditës

Negociata për shqiptarët... me kushte

Nga Mimoza Koçiu

(vijon nga faqja 1)

... i Komisionit Europian, bazuar në raportet e progresit të këtyre dy vendeve. Teksa vendimi final pritet të merret nga kryeministrat e presidentët e vendeve të BE-së, në samitin e Këshillit Europian më 29 qershor, skeptikët e njohur europianë duken kokëfortë.

Mes Francës, Holandës e Gjermanisë, dy të parat janë skeptikët të betuara të zgjerimit, kur vjen fjala për vendet e rajonit, pjesë e Ballkanit Perëndimor. Secila për arsye të ndryshme, nuk janë të bindura se negociatat për Shqipërinë e Maqedoninë duhet të hapen këtë vit. Emmanuel Macron, 40-vjeçari ambicioz, që prej një viti është Presidenti i Francës, dukshëm po synon të marrë një rol protagonist në BE, duke imponuar politika të reja, nisur edhe nga dobësimi i figurës së Merkel në mandatin e saj të katërt në Gjermani, e largimi i pritshëm i një tjetër aktori me peshë si Britania e Madhe, ndërsa në ambicie për një rol vendimarrës brenda BE, e konkurrojnë fort politikanët e sapozgjedhur në Itali, kryeministri 31-vjeçar i Austrisë, apo edhe një kryeministër autoritarist si Viktor Orban i Hungarisë.

Me këtë garë jo aq të padukshme, për ndryshimin e balancave të fuqisë politike brenda Unionit, hapja e negociatave, jo gjithnjë kuptohet si një proces që kërkon vite të tëra bisedime, e 35 kapituj për t'u monitoruar e negociuar, para se një vend, të jetë gatë të ulët në tryezën e BE, si anëtar i saj. Ndryshe nga Franca, Holanda mbetet konsekuente konkrete në skepticismin e saj, pasi kërkon rezultate bindëse përparimi nga këto dy vende.

Në rastin e Shqipërisë, Holanda e Franca kanë shkëlqyer me kundërshtinë e tyre, edhe në kohën e liberalizimit të vizave, e në dhënien e statusit të vendit kandidat. Janë dashur përparime konkrete, jo vetëm në letër, për t'i bindur në përgjigjen pozitive.

Merkel me heshtjen e saj, edhe pse Gjermania është e renditur mes skeptikëve, nuk duket se e mendon njëjloj. Llobimin këmbëngulës shqiptar e ka ndërjetë vetë Kancelarja, kur të majtë e të djathtë, ia ka dalë t'ia përçajmë, sipas kahjeve politike, edhe deputetët e grupit të vet parlamentar, në pro e kundër hapjes së negociatave me Shqipërinë. Politikane me përvojë, Kancelarja nuk ka pranuar të marrë anë, edhe pse duket se më mirë se të tjerët, e kupton efektin që do krijonte në rajonin tonë, një refuzim i BE për hapjen e negociatave me Shqipërinë e Maqedoninë. Këtë mëdyshje që lidhet me rritjen e influencës ruse e turke në rajon,



e kanë lexuar qartë aktorët politikë shqiptarë, që po intensifikojnë llobimin në Bundestag.

Përtëjtë dritëhijeve të BE, rezervat për Shqipërinë, janë ato që çdo shqiptar, i njeh mirë, e i has në të përditshmen e vet. Reforma në drejtësi, që po tentohet të paraqitet si sukses me vlerë, në fakt, vetëm sa ka nisur, ndërsa efekt të dukshëm dëmtoes, ka sjellë shkrirjen e Gjykatës Kushtetuese, e futjen në ngërç të Gjykatës së Lartë, dy institucione kyçe që garantojnë shtetin e të drejtës, kriterin e dytë të Kopenhagenit, një prej katër kërkesa bazike për t'u afruar BE-së. Vetingu i sponisur për njerëzit e drejtësisë, nuk e fsheh dot këtë realitet kokëfortë, që spikat edhe me mosngritjen e institucioneve të tjera të reformës, më të rëndësishmet, KLGJ, KLP e për pasojë as SPAK e BKH, organet e pavarura të hetimit, të paralajmëruara se do kapin peshqit e mëdhenj. E me këtë ritëm, Shqipëria nuk garanton dot një afat, se kur këto institucione do ngrihen, e madje as vetë Gjykatën Kushtetuese. Njëjloj, rrvotimi i pjesës së organit të akuzës, nuk po sjell asnjë ndryshim: peshqit e mëdhenj vazhdojnë t'i shpëtojnë rrjetës së drejtësisë, e madje në raste flagrante politikanësh, kujdeset mazhoranca me forcën e kartonëve t'u sigurojë mbrojtje, ndërsa ritmi i punës së drejtësisë, dukshëm pulson në sinkron me nevojat e politikës, e jo të së drejtës. Pra, edhe me një reformë të sponisur, Shqipëria nuk do japë dot shembuj, si ish-

presidenti francez Sarkozy, nën hetim të dyfishtë për financime të dyshimta e ndikim të paligjshëm në fushatën presidenciale të 2007, apo ish-presidenti gjerman Christian Wulf, i detyruar të dorëhiqej, pasi kishte pranuar favorizime ekonomike, duke shkelur detyrën, e njëjloj edhe Horst Koler para tij. Në Shqipëri akuzat ndaj politikkanëve me poste zyrtare shkojnë nga korrupsioni, deri tek lidhjet e favorizimi politik i krimin e narkotrafikut, por asnjë nuk përgjigjet apo dorëhiqet.

Në këtë realitet Oruellian, ku vetë OSBE pranon fenomenin e shitblerjes së votës në zgjedhje, qytetarët mbeten të pafuqishëm përballë arrogancës numerike, e fuqisë financiare të dyshimtë, të atyre që i qeverisin. Për pasojë, qytetarëve shqiptarë, që prej 28 vjetësh, pas gati 5 dekadash izolimi komunist, mbeten me entuziasëm në rajon, për t'u bërë pjesë e BE, u duhen hapur negociatat, edhe pse është e qartë se politikanët përgjegjës, nuk i kanë përmbushur detyrimet e janë në shkëlqje flagrante të çdo norme, ku beson BE. Por ama hapja e negociatave të anëtarësimit, duhet të vijë me kushte të forta, për të çmontuar paprekshmërinë e politikanëve me pushtet, para ligjit. Këtë mund ta bëjë vetëm BE, përmes mekanizmave të saj monitorues e imponues. Kushte e rezultate të prekshme, që do rrezojnë fasadën e rreme potemkiane, që djallëzishmëri ndërton pushteti për t'ia hedhur BE-së, njëjloj sikurse bën çdo ditë me qytetarët e vet, me

inskenime e parada suksesesh, deri në kufijtë e qesharakes.

Nga ana tjetër, koha është që BE të hedhë hapin sfidues, e të merret seriozisht me rajonin tonë, të cilit prej samitit të Selanikut të 2003, i premtim integrim. 28 vjet pas rënies së perdes së hekurit, 5 vjet pas zgjerimit të fundit, e në pritje të humbjes së një anëtarit influent si Mbretëria e Bashkuar, koha ka ardhur, që BE të krijojë një histori sukcesi, jo thjesht me hapjen e dritës jeshile për Shqipërinë e Maqedoninë, por për të kryer aktin e duhur, në një rajon ku fuqia e Unionit me këtë lloj hezitimi, veçse dobësohet, në dëm të vetë investimit gati 30-vjeçar për demokratizim.

Shqetësimet e drejta mbi korrupsionin, krimin e organizuar, shtetin e së drejtës, duhet të peshohen mirë, edhe me nivelin e përgjegjësiave, përkundëjtë mesazhit që duhet të japë BE, për fuqinë e vet transformuese, e jo imazhin e një klubi të mbyllur, ku interesat e brendshme kombëtare, dominojnë ato të përcaktuara që prej themelimit të tij. Procesi i nisur tashmë me hapjen e negociatave të anëtarësimit për Malin e Zi e Serbinë, me ambicionin e shpallur për vitin 2025 si moment anëtarësimit, duhet të vazhdojë edhe me vendet e tjera në pritje, më të parat Shqipëria e Maqedonia, si një vlerësim për qytetarët e këtyre vendeve, e aspak për udhëheqësit politikë, që duhet thënë se komoditetin e kësaj lloj qeverisjeje, e sigurojnë edhe me mbështetjen e dyshimtë, të diplomatëve nga BE.

HOROSKOPI

DASHI

Nëse nuk jeni të sigurt për ndjenjat tuaja, mos hyni në lojë: rrezikoni të krijoni ndonjë situatë të pakëndshme, për të cilën mund të pendoheni. Përparsa se t'i futeni kokë e këmbë një ndërmarrjeje, do të ishte mirë të vlerësonit të mirat dhe të keqat.

DEMI

Të shpërblyer nga Venusi në shenjë e juaj që përçajmë Hënë, do të përballeni me vendosmëri dhe optimizim pengesa të mundshme. Nëse keni dyshime në lidhje me një gëshhtë, është e kotë të shqetësoheni. Duhet të vazhdoni më tej.

BINJAKET

Është koha e duhur për të ndërtuar me vendosmëri dhe durim bazat për të zhvilluar më tej projekte të ndërmarrjes. Jepini pral Do të dini të shqyrtoni në mënyrë të prerë dhe me zgjuarsi gëshhtë shumë delikate dhe të rëndësishme që kanë të bëjnë me punën.

GAFORJA

Me Venusin, Marsin dhe Uranin që ju favorizojnë do të rinovoni disa aspekte në fushën e dashurisë, për të vendosur me shumë mirëkuptim me partnerin. Me Hënën miken do të dini të ëndëroni, por mbajni sytë hapur kur vjen puna për bazën materiale!

LUANI

Neptuni jo i favorshëm ju bën të jeni më të ndjeshëm. Bëni kujdes, sepse jeni më të prirur ndaj negativitetit të personave që ju rrethojnë. Në dashuri, kiji idetë e qarta dhe dilni drejtë në temë, duke shmangur dyshime dhe ngurime të kota.

VIRGJERESHA

Për meritë të Saturnit dhe Uranit miq, në punë mund të ndërmerrni një nisim pak të sforcuar, për të shënuar rezultate të mira. Me një qiell pozitiv si juaji, ndiheni plot me energji: mbylleni atë që ju ka mbetur pezull!

PESHORJA

Gjithçka do të shkojë për më mirë, mbi të gjitha nëse kërkoni të veproni në aktivitetin tuaj, gjithmonë duke u bazuar në kriteret e paanshmërisë dhe respektit për të tjerët. Hëna është dike, dhe sot do të keni si situata pozitive ashtu edhe tensione.

AKREPI

Me Saturnin që ju mbështet do të vini në pah nevojën për t'u përmbushur profesionalisht në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. Urani e keni kundra sot. Një pengesë mund t'ju shfaqet para rrugës suaj, por që keni mundësi ta kaloni.

SHIGJETARI

Sot duhet të bëni kujdes me ata që nuk janë duke ju thënë të vërtetën. Nuk mund të bëni më sikur nuk e kuptoni: është koha për sqarime. Do të përfiloni nga një frymëzim nisimtar, që do të mbështetet nga fantazia dhe krijimtaria.

BRICJAPI

Për shkak të Uranit dhe Plutonit armiqësor, shmangni të ngrënit dhe të pirët jash-të mase si edhe lodhjen e tepërt. Duhet të logaritni mirë forcat tuaja, me Marsin kundër parashikohet disa shqetësime, o të jeni nën trysni nga angazhime të shumta.

UJORI

Pas ditësh të mbushura me angazhime, po vijmë momente më të qeta. Do të ndiheni në formë, të qetë dhe në dispozicion të personit që ju qëndron në krah. Do të keni mundësinë të kaloni në veprim, duke realizuar edhe gjëra që i konsideroni shumë të vështira.

PESHQIT

Me Hënën që i buzëqesh Venusit, ngjarje entuziazmuese dhe sensuale do t'ju stimulojnë jetën sentimentale. Do të dini të përcjoni gëzim kudo. Një Uran i shkëlqyer do të vërë në plan të parë mendjemprehtësinë tuaj. Mësoni t'i besoni intuitës suaj.

As Salah nuk e shpëtoi Egjiptin Rusia thyen 'faraonët' dhe kualifikohet për më tej



Rusia kërkonte fitoren për të siguruar kalimin e grupit, Egjipti po ashtu donte suksesin për të mbajtur gjallë shpresat për një kualifikim, ndaj në Shën Pjetërburg, të pranishmit panë një futboll të mirë. Pjesa e parë ishte e ekuilibruar në raste, ndonëse më shumë dëshirë pati nga djemtë e Çerçesovit. Rusia e nis vrullshëm ndeshjen dhe jep sinjalet e para në çerekorëshin e parë të takimit, ndërsa Egjipti do ta ngrejë lojën më pas. Të

zotët e shtëpisë i shkojnë pranë avantazhit në disa momente, por kërcënim real për El Shenauin nuk ka, ndërsa në fundin e pjesës së parë është Egjipti bëhet më kërcënues, tekta në minutën e 42-të, Salah mund të kishte bërë vërtet dëm, kur gjuan vetëtimthi, por topi del ngjitur me shtyllën. Pjesa e parë mbyllet me rrjeta të paprekura, ndërsa e dyta nis me një vrull të fuqishëm të "arinjve" rusë. Por më parë Egjipti duhet të vuajë sërish mallkimin

e autogolit. Pas atij kundër Marokut, është radha e kapitenit Fati, që fatkeqësisht devijon në portën e tij një gjuajtje pa pretendime të Zobnin, duke çelur rezultatin e ndeshjes. Rusia rrit presionin për të mbyllur takimin, ndërsa Egjipti është tronditur. Në minutën e 59-të Rusia dyfishon. Fernandez krosin nga e djathta, ndërsa Çerishev me të majtën kalon topin mes këmbëve të El Shenauit, duke bërë që të shpërthejë për të dytën herë stadiumi "Krestovski". Madje, për tifozët nuk ka kohë as që të ulen në ndenjëset e tyre se 180 sekonda më pas Xjuba pasi kontrollin topin në zonë, me të djathtën vulos një gol shumë të bukur! Egjipti është dorëzuar. Madje edhe ndaj fatit, pasi edhe kur mund të shënojë me Trezege, topi nuk

del ngjitur me shtyllën. Por nëse nuk ke fat, mjafton të kesh VAR-in me vete. Kështu ndodh me Egjiptin në minutën e 72-të, me kryesorin Enrike Kaseres nga Paraguaji, që akordon penallti për "faraonët" pas ndërhyrjes së teknologjisë. Salah nga pika e bardhë nuk gabon, duke shënuar golin e parë për Egjiptin në këtë Kupë Bote dhe të parin për vete në një Botëror. Afrikanët përpigjen të rikthehen në lojë dhe synojnë një tjetër gol, por pavarësisht dëshirës, rezultati nuk do të ndryshojë dhe Rusia siguron trepikëshin e radhës në ndeshjen e dytë dhe bëhet skuadra e parë që kalon në fazën e 1/8-ave të Kupës së botës, ndërsa Egjipti duhet të shpresojë vetëm në një mrekulli.

Kagava dhe Osako zhvlerësojnë Kinteron, ndërsa autogoli i Cionek dhe Niang bëjnë me krahë afrikanët

Jeton Selimi



Grupi H, grupi i befasive, fitojnë Japonia e Senegali Shemben keqas Kolumbia dhe Polonia

Polonia dhe Senegali i dhanë jetë një beteje të fortë në "Luzhniki" të Moskës, duke zhvilluar një 90-minutësh me ritëm të lartë dhe shumë të ashpër në aspektin fizik. Pjesa e parë e takimit u karakterizua nga loja e shpejtë e të dyja skuadrave, por raste të mirëfillta goli nuk pati as Polonia e as Senegali, ndonëse zbritjet nuk mungojnë nga të dyja skuadrat. Afrikanët e nisnin më me vrull sfida, por ngadalë Polonia fiton terren dhe përpigjet të çajë në mbrojtjen e Senegalit. Por asgjë nuk do të ndodhë deri në minutën e 37-të, kur djemtë e Aliu Sise do të prishin balancat në rezultat. Senegali sulmon me Niang, që pason në qendër për Mane. Sulmuesi i Liverpoolit hap lojën më në të djathtë për Gueje, i cili gjuan një gjuajtje që duket pa pretendime, por që me devijimin e Cionek bëhet letale për Sheznin. 1-0 dhe Senegali bën të heshtin mijërat e polakëve në Luzhnik. Polonia shokohet, madje mund ta kishte mbyllur pjesën e parë me 10 vetë nëse gjyqtari Shukral nga Bahreini do të kishte nxjerrë të me kartonin e kuq Krishovjakun, i ndëshkuar më parë. Në pjesën e dytë, Polonia



hidhet në sulm dhe provon të baraspeshojë gjithçka me Levandovskin, por Khadim Ndiaye grushton shkëlqyeshëm. Të besuarit e Navalkës vijojnë të ushtrorin presion, por ata që shënojnë janë senegalezët. Minuta e 60-të dhe mbrojtja polake bën një gabim të rëndë, duke harruar kundërshtarin Niangun, i cili nuk e kreu zëvendësimin dhe Cionek e Shez-

ni nuk merren vesh mes tyre, duke i dhënë mundësi sulmuesit të Torinos, që me portën bosh e ka si një lojë fëmijësh të shënojë. Polonia tronditet. Levandovski, Milik e Zielinski janë fare të paqartë në fazën ofensive, ndërsa mbrojtja vuan shpejtësinë e afrikanëve. Polonia hidhet e gjitha para në minutat e fundit dhe do arrijë të rikthehet

në ndeshje në minutën e 86-të, kur Krishovjak me kokë realizon golin e parë për bardhekuqtë. Senegali tërhiqet për të mbrojtur një fitore të çmuar, ndërsa Polonia rreket më kot të barazojë, pasi deri në fund rezultati nuk do të ndryshojë, me afrikanët që sigurojnë një fitore të çmuar, ndërsa Navalka duhet të ndreqë shumë gjëra në ekipin e tij.

HABIT JAPONIA

Kolumbia e ka humbur takimin në ditën e djeshme përballë Japonisë, duke u mundur me rezultatin 1-2. Ky rezultat është vazhdimi i shumë surprizave të tjera, të cilët në Botërorin e Rusisë kanë qenë të shumta edhe pse nuk është mbyllur ende turi i parë. Kombëtarja e Kolumbisë shihet si një nga favoritët për të dalë nga grupi, pasi ka shumë futbollistë me kualitete të mëdha. Por këto nuk

BOTERORI RUSI 2018		
Grupi H		
Kolumbi - Japoni	1	2
Poloni - Senegal	1	2
Renditja		
Skuadra	N	P
Japonia	1	3
Senegali	1	3
Kolumbia	1	0
Polonia	1	0

kanë mjaftuar asnjëherë në takimet e zhvilluara deri më tani. Surpriza ka nisur që në minutat e para, tekta Sanchez është ndëshkuar me kartonin e kuq që në minutën e 3, ndërsa Kagava ka shënuar nga pika e bardhë. Kinteron riktheu shpresën te kolumbianët falë një ekzekutimi të goditjes së denimit në mënyrë të mrekullueshme, ndërsa Osako ka mbyllur takimin me rezultatin 1-2.

SPANJË-IRAN

Duel trajnerësh, Hiero vlerëson mësuën Keiroz

Pas barazimit me Portugalinë, Spanja është e detyruar për të fituar në ndeshjen e radhës kundër Iranit për të kaluar në raundin me eliminim direkt. Për më tepër, të besuarit e Fernando Hierro synojnë të shënojnë sa më shumë gola për t'u renditur të parët në Grupin B. "Ne duhet të harrojmë për Portugalinë. Irani po vjen, pritshmëritë janë të mira, kemi pasur ndjenja të mira, por kemi një ndeshje të rrezikshme. Do të ketë vështirësi, por kemi besim. Irani ka koncepte shumë të qarta dhe i qëndrojnë besnik skemës së tyre. Ata shquhen për fizikun e tyre, ndërsa janë të rrezikshëm. Queiroz ka gjithçka për ta përgatitur shumë mirë një ndeshje". Ndërkohë, trajneri portugez i Iranit, Karlos Keiroz, vlerëson Spanjën dhe minimizon shanset e ekipit të tij për të kaluar më tej. "Spanja është një skuadër e madhe dhe nuk ka nevojë ta them unë këtë. U kam thënë lojtarëve të mi përpara Kupës së Botës se Spanja, Portugalia dhe Maroku kanë tri rezultate në favor, me vetëm dy. Besoj se e kemi të vështirë të kalojmë turin, ndonëse e fituam ndeshjen e parë".

PORTUGALI-MAROK

Santos s'ka veç Ronaldo, Renar duhet të ndalë Ronaldo

Portugalia luan kundër Marokut ndeshjen e dytë dhe sytë janë drejtuar nga Kristiano Ronaldo. Fernando Santos e di se trepikëshi praktikisht mbyll kualifikimin, ndaj atë synim ka.

"Ndeshja e radhës për është e rëndësishme si për ne për kundërshtarin, por ne kemi mundësi për të bërë më mirë sesa bëmë me Spanjën. Ronaldo është një vlerë e shtuar për Portugalinë, por ne kemi edhe 22 lojtarë të tjerë. Duhet të marrim fi-

toren që të jemi të qetë". Ndërkohë, trajneri Herve Renar ka dhimbje koke. Portugalia është e fortë, por ka edhe një snajper të pagabueshëm, Kristiano Ronaldo. "E çfarë të them unë për Kristiano? Çfarë ka mbetur ende pa u thënë për të? Ajo që më mbetet është të hartoj një plan kundër tij, por ai e gjen gjithnjë një mënyrë për ta prishur. Është një lojtar i jashtëzakonshëm".

URUGUAI-ARABI SAUDITE


Tabarez është i qetë, Pizi ka frikë dyshen Suarez-Kavani

Pasi ka mposhtur Egjiptin, Uruguai i Oskar Uashington Tabarez po përgatitet për ndeshjen kundër Arabisë Saudite. Për trajnerin bëhet fjalë për Botërorin e katërt, por gjithnjë ai deklaron se ka se ç'të mësojë. "Çdo herë kuptoj diçka më

shumë nga një Kupë Bote dhe ajo është pjesëmarrja, të jesh aty. Në fillim ishim të shqetësuar se deri ku do të shkonte Uruguai, por të jem i singertë, deri tani kemi ecur mirë". Arabia Saudite pësoi 5 gola kundër Rusisë dhe kuptohet që në këtë ndeshje, tra-

jni Huan Antonio Pizi shqetësimin më të madh e ka për sulmuesit e Uruguait. "Çdo ndeshje është e vështirë dhe taktikat varen nga kundërshtari. Uruguai është ndryshe nga Rusia. Uruguai ka dy lojtarë të klasit botëror, por ne kemi prioritetet tona dhe ato janë më të rëndësishme sesa Suarez dhe Kavani. Duhet të tregojmë se jemi të aftë të konkurrojmë".

Fjalëkryqi (1)



35. Martin i Norma Rae.
36. Mund të jenë filmi.
38. Një jepet për hartim.
39. Ami i Maupassant.
41. Fundi i Turandot.
42. Halli këngëtare.
45. Neilli i Jurassic park.
47. Pineda e Garcia Lorca-s.
48. Giorgio stilist
- VERTIKAL**
1. Morisette këngëtare.
2. Kilmer aktor.
3. Heche aktore.
4. Fillojnë tatëpjetën
5. Eshhtë diapozitiv shumë i ndjeshëm.
6. Mbyllin spitale.
7. Në krye të masave.
8. Bëjnë shirit me shi.
9. Qe vajza e Tantalit.
10. Janë më shumë se dëshira
12. Ishte dekret i sulltanit.
15. Qe mbreti i urtë i Pilos.
16. Quinn aktor.

HORIZONTAL

5. Pupi regjisor.
9. Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve
11. Turner aktore.
12. Fillojnë festat.
13. Skuadër greke.
14. Falen pa fe.
15. U shkrua nga Gorkij.
18. Një sferë për... model.
19. Janë bisha.
22. Parashtesë për dy.
23. Demoni që persekutonte Sarën.
24. Stacion i famshëm orbital.
25. Mendes regjisor.
27. Një rreth i ngushtë miqësor
29. Film me Robert de Niro dhe Jean Reno
30. Këndohen në opera.
32. Eshhtë lajm i vjetër.
34. Sharif aktor.

17. Gasol i NBA.
20. Fillojnë garën.
21. Një pjesë e reformave.
26. Eshhtë si biskotë.
28. Mund të jetë karmelitan.
29. Sjellin shi.
30. Bel i Maupassant.
31. Direk pa ekstreme.
33. Gjysma e bimëve.
34. Mbyllin një motor.
36. Eshhtë bitum.
37. Fara këngëtare.
38. Hanks aktor
39. Stiller aktor.
40. Morrison rockstar.
42. Fillojnë masat.
43. Në krye të tabelës.
44. Dorisa janë në fund.
46. Fund filmi.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Film i hitchcock.
6. Fillojnë premierën.
7. Janë legjendat.
11. Kush ka... ka zët.
12. Thurman aktore.
15. Një pjesë e testamentit
16. Një pjesë e studimeve.
18. Kështu është situata e tensionuar.
21. Telefoni në kartvizitë.
22. Eshhtë ngasje.
24. Në krye të autoriteteve.
25. Mbyllin mbledhjen.
26. Pason abetaren.
29. Fillojnë aafrimin.
30. Cocker këngëtar.
31. Bartok kompozitor.
33. Tiriac që qe tenist.

VERTIKAL


35. Oxa këngëtare.
36. Kalimi në ekstreme.
37. U shkrua nga Zola.
39. Fise pa fe.
40. Eshhtë mballomë.
41. I mungon apatikut.
43. Një pjesë e medaljeve.
44. Një këngëtar lirik.
46. Pak torturuese.
48. Ka privilegjin e jetës.
51. I famshmi Pacino.
52. Nasi shkrimtar.
53. Janë temperaturat më të ulëta.
54. Me pit në box.
- VERTIKAL**
1. Janë enigmatikë.
2. Emri i Vivaldit.
3. Rrjedh në klepsidër.
4. Inicialet e Selleck aktor.
5. Fillojnë rubrikën.
6. Ishte babai i Prokinit dhe Filomelës.
8. Vitet pa kufij.
9. Mbyllin kanate.
10. U shit për një pjatë thjerza.
13. ... e shëndoshë në trup të shëndoshë.
14. Moore aktore.
17. Rocca aktore.
19. Janë përmasa.
20. Fund dhjetori.
23. Mbyllin krahum.
26. Fillojnë kalimin.
27. Duhet ruajtur.
32. Ishte Europa komuniste.
34. Agjenci Kombëtare Lokale
38. Berg kompozitor.
40. Të parat në Amsterdam.
42. Elsa këngëtare.
45. Memoria në computer
47. Me të nxjerrin trarë.
49. Në mes të dhomës.
50. Ekstreme kateti.
52. Kufijtë e lutjes.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

5			3	7	2
		5			9
			2	5	6
		6		4	
9		1			7
		2	4	1	
	2	6	8		4
8	3	4		5	7
6					

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	1	4	6	9	3	8	5	2
5	2	3	7	4	8	9	6	1
8	6	9	1	5	2	3	4	7
6	5	8	4	1	7	2	9	3
9	7	1	2	3	5	4	8	6
3	4	2	9	8	6	7	1	5
1	8	7	5	2	9	6	3	4
2	3	5	8	6	4	1	7	9
4	9	6	3	7	1	5	2	8

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Aftësia mund të të çojë në krye, por vetëm karakteri mund të të mbajë lart atje.

- Kemi mjaft kontroll mbi armët. Ajo që na duhet është kontrolli mbi idiotët.

- "Gjëja më e mirë në jetë, është të gesh dikë që njeh të gjitha dobësitë e tua, dhe vazhdon të besojë se je i mahnitshëm"



KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

5	1	11	18	3	10	18	2	1	15	20
3	2	6	5	3	2	1	5		13	1
21		4	3	5	6	2	1	5	5	10
1		6	10	1	2	8	11	6	4	1
2	13	7	2	1	5	1		1	2	8
	19	1	7	3	5	6		15	14	10
13	3	5	2		5	6	11	1	1	5
5	2			21		19	6	2	1	5
1	5	7		6	2	8	5	10	8	6
16	8	7	8	17	6	5		1	6	21
6			15	8	5	1	5		18	3
4	3	18	8	7	6		18	6	4	6

E	P	O	S		M	P	L			
R	E	T	E		V	A	R	I	A	N
E	L	I		T	E	N	I	S	T	E
N	E		K	A	P	I	T	U	L	L
D	M	I	U	R	A	S	E	S		
E	A	L	L	A	K	U	T	O	T	
K	A	M	A	T	E		I	N	O	
A	S	E	N	T		T	K	P		
V	A	R	T	I		I	R	A	N	I
A	L	T	E	M	I	L	E	D		
R	O	J	E	T		K	E	N	D	E
I	N	E	S		P	A		I	N	R

Thënie të mëncura

- Shkoni aq larg sa mund të shihni. Kur të arrihi atje, do të jeni në gjendje për të parë akoma më larg.
- Dashuria është çështje fizike, martesë është çështje kimie.
- Mos u mundoni për të kuptuar shoqërinë. Ajo duket njerëzore, por ndryshon vazhdimisht fytyrën.
- Ka njerëz që sa më shumë të bëni për ta, aq më pak ata bëjnë për veten e tyre.

PËRGJIGJET E FJALËKRYEQVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

R O D C E T P E T E R
O D L U A N E T K A K A
M M E P A L O M E N I T I
A A M E P A L A M E D I D
R L A R A S N O B D
R I O A K T A N D
Z E T A T U S O E L I
S P I T F A R I S E J
A T A M F I T I C H E
R I R U M J O S O N
E T A L B O T S T N I
L I U A I E C O L A

D S H A K L E D
E M O N T E L L A I
P S U G O R D O N P Y M
E M E P A R M E N I D I
R O T A R E B E L D
S U O M I E T A A P A
E L I O T S I R A N
T I L F K A L E N D A
N E A R S E N H I R I
A S A E A T L I K U D
R R R E T H S O U R A
T O A L I N O T A I T

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

GSH

www.gsh.al

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

Tashmë edhe lundroni!

